

AXHENDA E RE URBANE



Translation accuracy is not guaranteed nor implied. If any questions arise related to the accuracy of the information contained in the translation, please refer to the New Urban Agenda document endorsed by the General Assembly (A/RES/71/256*) which is the official version of the document. Any discrepancies or differences created in the translation are not binding and have no legal effect for compliance or enforcement purposes.

Translation in Albanian kindly provided by the Ministry of Urban Development of Albania.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

AXHENDA E RE URBANE



United Nations

DEKLARATA E
KUITO-S MBI
QYTETET E
QËNDRUESHME
DHE VENDBANIMET
PËR TË GJITHË

1. Ne, Krerët e Shteteve dhe Qeverive, Ministra dhe Përfaqësues të Lartë, jemi mbledhur në Konferencën e Kombeve të Bashkuara mbi Strehimin dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban (Habitati III) nga data 17 deri në 20 tetor 2016, në Kuito, me pjesëmarrjen e qeverive rajonale dhe lokale, parlamentarëve, shoqërisë civile, popullsisë indigjene dhe komuniteteve lokale, sektorit privat, profesionistëve, komunitetit shkencor dhe akademik, dhe palëve të tjera të interesuara, për të miratuar Axhendën e re Urbane.

2. Deri në vitin 2050, popullsia urbane në botë pritet thuhet të dyfishohet, duke e bërë urbanizimin një nga tendencat më transformuese të shekullit të 21-të. Popullsia, aktivitetet ekonomike, ndërveprimet sociale dhe kulturore, si dhe ndikimet mjedisore dhe njerëzore, janë gjithnjë e më të përqendruara në qytete dhe kjo paraqet sfida madhore për qëndrueshmërinë, ndër të tjera, në lidhje me strehimin, infrastrukturën, shërbimet bazë, sigurimin e ushqimit, shëndetin, arsimin, punët e denja, sigurinë dhe burimet natyrore.

3. Që nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara mbi Vendbanimet Humane, mbajtur në Vankuver/Kanada, në 1976 dhe në Stamboll/Turqi në 1996, si dhe nga miratimi i Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit në 2000, ne kemi parë përmirësime në cilësinë e jetës së miliona banorëve të zonave urbane, duke përfshirë dhe banorët e lagjeve të varfëra dhe vendbanimeve informale. Megjithatë, vazhdimësia e formave të shumta të varfërisë, e pabarazive në rritje, si dhe e degradimit të mjedisit, mbeten ndër pengesat më të mëdha për zhvillimin e qëndrueshëm në mbarë botën, bashkë me përjashtimin social dhe ekonomik dhe segregimin hapësinor, të cilat paraqesin shpesh një realitet të pakundërshtueshëm në qytetet dhe vendbanimet humane.

4. Jemi ende larg trajtimit të përshtatshëm të këtyre sfidave, të sfidave të tjera ekzistuese, apo të sfidave që do të lindin në të ardhmen. Ne duhet të përfitojmë nga mundësitë që ofron urbanizimi, i konsideruar si motor për rritjen ekonomike të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, për zhvillimin social dhe kulturor dhe për mbrojtjen e mjedisit, si dhe për kontributet e mundshme të tij për arritjen e zhvillimit transformues dhe të qëndrueshëm.

5. Duke ritrajtuar mënyrën se si janë planifikuar, financuar, zhvilluar, qeverisur dhe menaxhuar qytetet dhe vendbanimet, Axhenda e Re Urbane do të ndihmojë për t'i dhënë fund varfërisë dhe urisë në të gjitha format dhe dimensionet e saj; do të zvogëlojë pabarazitë; do të nxisë rritjen ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme; do të arrijë barazinë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave, me qëllimin që ato të japin sa më të plotë kontributin e tyre për zhvillimin e qëndrueshëm; do të përmirësojë shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve; do të nxisë aftësitë ripërtëritëse; dhe do të mbrojë mjedisin.

6. Ne marrim plotësisht parasysht arritjet më të rëndësishme të vitit 2015, në veçanti, Axhendën 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm,¹ përfshirë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-të), Axhendën për Veprim të Adis Abebas në Konferencën e Tretë Ndërkombëtare mbi Financimin për Zhvillim,² Marrëveshjen e Parisit të miratuar në bazë të Konventës Kuadër mbi Ndryshimet

¹ Rezoluta 70/1

² Rezoluta 69/313, aneks

Klimatike,³ Kuadrin Sendai për Reduktimin e Rrezikut të Katastrofave 2015-2030,⁴ Programin e Veprimit të Vjenës për Vendet në Zhvillim Pa Dalje në Det për Dekadën 2014-2024,⁵ SIDS Rruga e Modaliteteve të Përsheputura për Veprim (SAMOA)⁶ dhe Programin e Veprimit të Stambollit për Vendet më Pak të Zhvilluara për Dekadën 2011-2020⁷. Ne marrim parasysh gjithashtu dhe Deklaratën e Rios mbi Mjedisin dhe Zhvillimin⁸, Samitin Botëror për Zhvillimin e Qëndrueshëm, Samitin Botëror për Zhvillimin Social, Programin e Veprimit të Konferencës Ndërkombëtare mbi Popullsinë dhe Zhvillimin⁹, Platformën për Veprim të Pekinit¹⁰, Konferencën e Kombeve të Bashkuara mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe gjithshka ka dalë si rezultat i këtyre konferencave.

7. Ne marrim parasysh edhe Samitin Botëror Humanitar të mbajtur në maj 2016 në Stamboll, duke mbajtur parasysh se ai nuk përfundoi me rezultate të rëna dakord ndërmjet qeverive.

8. Ne njohim kontributin e qeverive kombëtare, federale dhe lokale, në përcaktimin e Axfordës së Re Urbane dhe marrim parasysh konkluzionet e Asamblesë së Dytë Botërore të Qeverive Lokale dhe Rajonale.

9. Kjo Axfordë e Re Urbane riafirmton angazhimin tonë global për zhvillimin e qëndrueshëm urban, si hap kritik për realizimin e zhvillimit të qëndrueshëm në mënyrë të integruar dhe të koordinuar në nivel global, rajonal, kombëtar, në nivel rajonal dhe lokal, me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve përkatës. Zbatimi i Axfordës së Re Urbane kontribuon për zbatimin e Axfordës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, në mënyrë të integruar, si dhe për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ), duke përfshirë Objektivin 11 për t'i bërë qytetet dhe vendbanimet humane gjithëpërfshirëse, të sigurta, rezistuese dhe të qëndrueshme.

10. Axforda e re Urbane e pranon se kultura dhe diversiteti kulturor janë burim pasurimi për njerëzimin dhe ofrojnë kontribut të rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm të qyteteve, vendbanimeve dhe qytetarëve, duke i fuqizuar ato në mënyrë që të luajnë rol aktiv dhe unik në iniciativat e zhvillimit. Axforda e Re Urbane e pranon, gjithashtu, se kultura duhet të merret në konsideratë gjatë promovimit dhe zbatimit të konsumit të ri të qëndrueshëm dhe të modeleve të prodhimit që kontribuojnë në përdorimin e qëndrueshëm të burimeve dhe trajtojnë ndikimin negativ të ndryshimeve klimatike.

³ Shiko FCCC/CP/2015/10, add 1, vendimi 1/CP21, aneks

⁴ Rezoluta 69/283, aneks II

⁵ Rezoluta 69/137, aneks II

⁶ Rezoluta 69/15, aneks

⁷ Raporti i Konferencës së katërt të Kombeve të Bashkuara mbi Vendet më pak të Zhvilluara, Stamboll, Turqi, 9-13 Maj 2011 (A/CONF 219/7), kap. II

⁸ Raporti i Konferencës së Kombeve të Bashkuara mbi Mjedisin dhe Zhvillimin, Rio de Zhaneiro, 3-14 qershor 1992, vol. I, Rezoluat e miratuara nga Konferenca (botim i Kombeve të Bashkuara, nr. E93.1.8 dhe korrigjime) rezoluta 1, aneks 1.

⁹ Raport i Konferencës Ndërkombëtare mbi Popullsinë dhe Zhvillimin, Kajro, 4-15 shtator 1995, rezoluta 1, aneks.

¹⁰ Raport i Konferencës së katërt Botërore mbi Femrat, Pekin, 4-15 shtator 1995, kap. I, rezoluta 1, aneksi II

Vizioni ynë i përbashkët

11. Ne bashkëndajmë vizionin e qyteteve për të gjithë, duke iu referuar përdorimit të barabartë dhe të gëzueshëm të qyteteve dhe vendbanimeve, duke synuar të promovojmë përfshirjen dhe duke siguruar që të gjithë banorët e brezave të sotëm dhe të ardhshëm, pa asnjë lloj diskriminimi, të jenë në gjendje të jetojnë dhe të krijojnë qytete dhe vendbanime të përshtatshme, të sigurt, të shëndetshme, të arritshme, rezistente, dhe të qëndrueshme, si një e mirë e përbashkët që në thelb kontribuon për prosperitetin dhe cilësinë e jetës për të gjithë. Ne i njohim përpjekjet e disa qeverive kombëtare dhe vendore për ta mishëruar këtë vizion, i njohur si “e drejta për qytet”, në legjisllacionin, deklaratat politike dhe kartat e tyre.

12. Ne synojmë të kemi qytete dhe vendbanime ku të gjithë njerëzit të jenë në gjendje të gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta, si dhe liritë e tyre themelore, të udhëhequr nga objektivat dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë respektimin e plotë të së drejtës ndërkombëtare. Në këtë drejtim, Axhenda e Re Urbane bazohet në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut¹¹, traktatet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, Deklaratën e Mijëvjeçarit¹² dhe Përfundimet e Samitit Botëror të vitit 2005¹³. Axhenda e Re Urbane mbështetet dhe në instrumente të tjerë të tilla si Deklarata mbi të Drejtën për Zhvillim¹⁴.

13. Ne parashikojmë qytete dhe vendbanime humane që:

(a) përbushin funksionin e tyre social, duke përfshirë edhe funksionin social dhe ekologjik të tokës, me synimin që progresivisht të arrihet realizimi i plotë i të drejtës për strehim të përshtatshëm, si pjesë përbërëse e të drejtës për një standard të përshtatshëm jetese, pa diskriminim, i së drejtës për një sistem sanitar të sigurt dhe ujë të pijshëm të sigurt dhe të pastër, si dhe akses të barabartë për të gjithë ndaj ujit të pijshëm të sigurt dhe të përballueshëm dhe shërbimeve të kanalizimeve, si dhe akses të barabartë për të gjithë në mallra publike dhe shërbime cilësore, në fusha të tilla si ushqimi dhe ushqyerja e sigurt, shëndetësia, arsimit, infrastruktura, lëvizshmëria dhe transporti, energjia, cilësia e ajrit, dhe mjetet e jetesës;

(b) janë pjesëmarrëse, nxitin angazhimin qytetar, krijojnë ndjenjën e përkatësisë dhe të pronësisë ndërmjet gjithë banorëve të tyre, i japin prioritet hapësirave publike të sigurt, gjithëpërfshirëse, të arritshme, të gjelbëra, me cilësi dhe miqësore për familjet; rrisin ndërvëprimet sociale dhe ndërmjet brezave, shprehjet kulturore, pjesëmarrjen politike, sipas rastit, nxisin kohezionin social, përfshirjen, dhe sigurojnë një shoqëri paqësore dhe pluraliste, ku përbushen nevojat e të gjithë banorëve, duke njohur nevojat e veçanta të atyre që janë në situata vulnerabël;

(c) sigurojnë barazinë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave, duke siguruar pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të grave, dhe të drejta të barabarta në të gjitha fushat dhe në

¹¹ Rezoluta 217A (III)

¹² Rezoluta 55/2

¹³ Rezoluta 60/1

¹⁴ Rezoluta 41/128, aneks

udhëheqje në të gjitha nivelet e vendimmarrjes për ta; duke siguruar punë të denjë dhe pagë të barabartë për punë të barabartë, ose punë me vlerë të barabartë për të gjitha gratë, si dhe duke parandaluar dhe eliminuar të gjitha format e diskriminimit, dhunës dhe ngacmimeve ndaj grave dhe vajzave në hapësirat publike dhe private;

(d) përballojnë sfidat dhe mundësitë e rritjes ekonomike të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse të sotmes dhe të së ardhmes, përdorimin e urbanizimit për transformim strukturor, produktivitetin e lartë, aktivitete me vlerë të shtuar dhe efikasitetin e burimeve, duke shfrytëzuar ekonomitë lokale, duke njohur kontributin e ekonomisë informale, dhe duke mbështetur një tranzicion të qëndrueshëm drejt një ekonomie formale;

(e) i përmbushin funksionet e tyre territoriale përtej kufijve administrativë dhe veprojnë si drejtues për një zhvillim urban dhe territorial të balancuar, të qëndrueshëm dhe të integruar në të gjitha nivelet;

(f) promovojnë planifikimin e përgjegjshëm ndaj gjinisë dhe moshës, nxisin investimet për lëvizjen urbane të qëndrueshme, të sigurt dhe të arritshme për të gjithë, dhe gjenerojnë sisteme efikase të transportit të pasagjerëve dhe mallrave, që lidhin në mënyrë eficiente njerëzit, vendet, mallrat, shërbimet dhe mundësitë ekonomike;

(g) miratojnë dhe zbatojnë uljen e rrezikut nga fatkeqësitë dhe menaxhimin e fatkeqësive, reduktojnë cenueshmërinë, ofrojnë mundësi dhe përgjigje ndaj rreziqeve natyrore dhe dëmeve të shkaktuara nga njerëzit, dhe nxisin zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike;

(h) mbrojnë, ruajnë, rivendosin, dhe promovojnë ekosistemet, ujin, habitatet natyrore dhe biodiversitetin e tyre, minimizojnë ndikimin e tyre në mjedis, si dhe ndryshojnë modelet drejt një konsumi dhe prodhimi të qëndrueshëm.

Parimet dhe angazhimet tona

14. Për të arritur vizionin tonë, kemi zgjedhur të miratojmë një Axtendë të Re Urbane të udhëhequr nga parimet e mëposhtme, të ndërlidhura me njëra-tjetrën:

(a) Askush të mos lihet pas, duke i dhënë fund varfërisë në të gjitha format dhe dimensionet e saj, duke përfshirë çrrënjosjen e varfërisë ekstreme, duke siguruar të drejta dhe mundësi të barabarta, diversitet socio-ekonomik dhe kulturor, integrim në hapësirën urbane, rritje të mundësisë për banim, siguri të ushqimeve dhe të ushqyerit, shëndet dhe mirëqenie; duke përfshirë dhënie fund të epidemive të AIDS, tuberkulozit dhe malaries, promovimit të sigurisë dhe eliminimit të diskriminimit dhe dhunës në të gjitha format; duke siguruar pjesëmarrjen e publikut duke ofruar akses të sigurt dhe të barabartë për të gjithë; dhe akses të barabartë për të gjithë në infrastrukturën fizike dhe sociale dhe në shërbimet bazë si dhe strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm.

(b) Ekonomi urbane të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, duke u mbështetur në përfitimet që vijnë si rezultat i urbanizimit të planifikuar mirë, produktiviteti i lartë, konkurrenca dhe inovacioni; nxitja e punësimit të plotë dhe produktiv, duke promovuar punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë; duke siguruar krijimin e punëve të denja për të gjithë dhe akses të barabartë në burimet dhe mundësitë ekonomike dhe prodhuese për të gjithë; duke parandaluar spekulimet mbi tokën; duke promovuar zotërimin e sigurtë të tokës dhe duke menaxhuar tkurrjen e tokës, kur është e mundur.

(c) Qëndrueshmëria e mjedisit, duke nxitur energjinë e pastër, përdorimin në mënyrë eficiente të tokës dhe burimeve në zhvillimin urban, si dhe mbrojtjen e ekosistemeve dhe biodiversitetit, duke përfshirë adoptimin e jetesës së shëndetshme në harmoni me natyrën; nxitjen e modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe të prodhimit; ndërtimin e rezistencës urbane; reduktimin e rreziqeve nga katastrofat; zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

15. Ne angazhohemi të punojmë për një model urban me kahje drejt një Axhende të Re Urbane që do të:

(a) Ritrajojmë mënyrën se si planifikojmë, financojmë, zhvillojmë, qeverisim, dhe menaxhojmë qytetet dhe vendbanimet, duke e njohur zhvillimin e qëndrueshëm urban dhe territorial si të domosdoshme për arritjen e zhvillimit dhe mirëqenies së qëndrueshme për të gjithë.

(b) Njohim rolin e rëndësishëm të qeverive në përcaktimin dhe zbatimin e legjislacionit dhe politikave urbane gjithëpërfshirëse dhe eficiente për zhvillimin e qëndrueshëm urban, dhe kontributet po aq të rëndësishme dhe të barabarta të qeverive rajonale dhe vendore, si dhe të shoqërisë civile dhe të aktorëve të tjerë përkatës, në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme.

(c) Miratojmë qasje të qëndrueshme dhe integruese ndaj zhvillimit urban dhe territorial, të përqendruara tek njerëzit, në përgjigje ndaj moshës dhe gjinisë, duke zbatuar politika, strategji, zhvillim kapacitetesh dhe veprime në të gjitha nivelet, bazuar në shtytësit kryesor të ndryshimit, duke përfshirë:

(i) Zhvillimin dhe zbatimin e politikave apo strategjive kombëtare urbane në kuadër të partneriteteve lokale-kombëtare, sipas rastit, duke ndërtuar sisteme kombëtare të integruara urbane për qytetet dhe vendbanimet drejt arritjes së objektivave kombëtare të zhvillimit;

(ii) Forcimin e qeverisjes urbane, me institucione dhe mekanizma të shëndosha që i fuqizojnë dhe përfshijnë aktorët urbanë, si dhe mekanizmat e duhur të mbikëqyrjes, duke ofruar parashikueshmëri dhe koherencë në planet e zhvillimit urban për të mundësuar përfshirjen sociale, rritjen ekonomike të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse dhe mbrojtjen e mjedisit;



(iii) Relancer la planification et l'aménagement urbains et territoriaux intégrés à long iii. Rigjallërimin e planifikimit dhe projektimit afatgjatë dhe të integruar urban dhe territorial për të optimizuar dimensionin hapësinor të formës urbane dhe për të shpërndarë rezultatet pozitive të urbanizimit;

(iv) Mbështetjen e kuadreve dhe instrumentave financiarë efektivë, inovatorë dhe të qëndrueshëm, duke bërë të mundur forcimin e sistemeve financiare dhe fiskale bashkiake dhe lokal me qëllim krijimin, mbështetjen dhe ndarjen e vlerave të gjeneruara nga zhvillimi i qëndrueshëm urban në mënyrë gjithëpërfshirëse.

Thirrje për veprim

16. Ndërkohë që kushtet specifike të qyteteve, qytezave dhe fshatrave ndryshojnë, ne pohojmë se Axehtënda e Re Urbane është universale në qëllimin e saj, pjesëmarrëse dhe e përqëndruar tek njerëzit, mbron planetin, dhe ka një vizion afatgjatë, duke përcaktuar prioritetet dhe veprimet në nivel global, rajonal, kombëtar, dhe lokal që qeveritë dhe aktorët e tjerë përkatës, në çdo vend, mund ta adoptojnë, bazuar në nevojat e tyre.

17. Ne do të punojmë për ta zbatuar këtë Axehtëndë të Re Urbane në vendet tona dhe në nivel rajonal dhe global, duke marrë parasysh realitetet, kapacitetet, dhe nivelet e ndryshme kombëtare të zhvillimit, dhe duke respektuar legjislacionet, praktikatat, politikat dhe prioritetet kombëtare.

18. Ne riafirmojmë të gjitha parimet e Deklaratës së Rios mbi Mjedisin dhe Zhvillimin, duke përfshirë, ndër të tjera, parimin e përgjegjësisë të përbashkëta, por të diferencuara, siç përcaktohet në Parimin 7 të saj.

19. Ne e pranojmë se në zbatimin e Axehtëndës së Re Urbane, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet trajtimit dhe zhvillimit unik të sfidave të zhvillimit urban me të cilat përballen të gjitha vendet, veçanërisht, vendet në zhvillim, duke përfshirë edhe vendet e Afrikës, vendet më pak të zhvilluara, vendet në zhvillim pa dalje në det, vendet e vogla ishullore në zhvillim, si dhe sfidat e veçanta me të cilat përballen vendet me të ardhura të mesme. Po ashtu, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet vendeve në situata konfliktesh, si dhe vendeve dhe territoreve nën pushtimin e huaj, vendeve në situata pas konfliktesh, dhe vendeve të prekura nga fatkeqësitë natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu.

20. Ne e njohim nevojën për t'i dhënë vëmendje të veçantë trajtimit të sfidave dhe formave të shumta të diskriminimit me të cilat ballafaqohen gratë dhe vajzat, fëmijët dhe të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara, personat me HIV/AIDS, personat e moshuar, popullsitë indigjene dhe komunitetet lokale, lagjet e varfëra dhe banorët në vendbanimet joformale, të pastrehët, punëtorët, bujqit e vegjël dhe peshkatarët, refugjatët, personat e kthyer dhe të zhvendosur brenda vendit, dhe emigrantët, pavarësisht nga statusi i emigrantit.

21. Ne i bëjmë thirrje të gjitha qeverive kombëtare, rajonale dhe lokale, si dhe të gjitha palëve të interesuara, në përputhje me politikat dhe legjisllacionin kombëtar, që të gjallërojnë, forcojnë dhe të krijojnë partneritete për të rritur shkallën e koordinimit dhe bashkëpunimit për të zbatuar në mënyrë efektive Axiendën e Re Urbane dhe për të kuptuar vizionin tonë të përbashkët.

22. Ne e miratojmë këtë Axiendë të Re Urbane si një vizion kolektiv dhe një angazhim politik për të nxitur dhe për të realizuar zhvillimin e qëndrueshëm urban, dhe si një mundësi historike për të luajtur rol kyç në qytetet dhe vendbanimet, si nxitëse e zhvillimit të qëndrueshëm në një botë gjithnjë e më të urbanizuar.

PLANI QUITO
I ZBATIMIT
PER AXHENDËN
E RE URBANE

23. Ne jemi të vendosur ta zbatojmë Axtendën e Re Urbane si një instrument kyç për qeveritë kombëtare, rajonale dhe lokale dhe të gjitha palët e interesuara për të arritur zhvillimin e qëndrueshëm urban.

Angazhimet transformuese për zhvillimin e qëndrueshëm urban

24. Për të shfrytëzuar plotësisht potencialin e zhvillimit të qëndrueshëm urban, ne marrim përsipër angazhimet transformuese të mëposhtme përmes një ndryshimi të modeleve urbane bazuar në dimensionet e integruara dhe të pandashme të zhvillimit të qëndrueshëm: social, ekonomik dhe mjedisor.

Zhvillimi i qëndrueshëm urban për përfshirjen sociale dhe dhënien fund të varfërisë

25. Ne jemi të ndërgjegjshëm se zhdukja e varfërisë në të gjitha format dhe dimensionet, përfshirë dhe varfërinë ekstreme, është sfida më e madhe globale dhe kërkesë e domosdoshme për zhvillimin e qëndrueshëm. Ne jemi gjithashtu të ndërgjegjshëm se rritja e pabarazisë dhe vazhdimësia e formave dhe dimensioneve të shumta të varfërisë, duke përfshirë dhe rritjen e numrit të lagjeve të varfra dhe të vendbanimeve informale, po prek si vendet e zhvilluara ashtu dhe ato në zhvillim, dhe se organizimi hapësitor, aksesit, dhe projektimi i hapësirës urbane, si dhe ofrimi i infrastrukturës dhe shërbimeve bazë, së bashku me politikatat e zhvillimit, mund të nxisin ose pengojnë kohezionin social, barazinë dhe përfshirjen.

26. Ne angazhohemi për një zhvillim urban të përqendruar tek njerëzit, që mbron planetin, që i përgjigjet moshës dhe gjinisë, si dhe realizon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, duke lehtësuar të jetuarit së bashku, duke i dhënë fund të gjitha formave të diskriminimit dhe dhunës, dhe duke fuqizuar të gjithë individët dhe komunitetet përmes pjesëmarrjes së tyre të plotë dhe të kuptimtë. Ne angazhohemi të promovojmë kulturën dhe respektin për diversitetin, dhe barazinë si elementë kyç në humanizimin e qyteteve dhe vendbanimeve tona.

27. Ne rikonfirmojmë zotimin tonë se askush nuk do të mbetet pas dhe angazhohemi të promovojmë mundësitë dhe përfitimet e barabarta që mund të ofrohen nga urbanizimi, dhe t'i u mundësojmë të gjithë banorëve që jetojnë në vendbanime formale apo joformale jetesë të mirë, dinjitoze dhe të dobishme dhe mundësitë për të arritur plotësisht potencialin e tyre human.

28. Ne angazhohemi të mbështesim respektimin e plotë të të drejtave të njeriut dhe trajtimit nejrëzor për refugjatët, personat e zhvendosur brenda vendit dhe migrantët, pavarësisht nga statusi i migrimit, si dhe komunitetet e tyre pritëse, duke marrë parasysh rrethanat kombëtare, duke pranuar se, edhe pse lëvizja e popullatave të mëdha në qytete dhe qyteza paraqet një mori sfidash, ajo mund të sjellë po ashtu dhe kontribute të rëndësishme sociale, ekonomike dhe kulturore në jetën urbane. Ne, gjithashtu, angazhohemi për forcimin e sinergjive ndërmjet migrimit ndërkombëtar dhe zhvillimit, në nivel global, rajonal, kombëtar, dhe lokal duke siguruar migracion të sigurt dhe të rregullt me anë të planifikimit dhe të mirëmenaxhimit të politikave për migracionin dhe duke i mbështetur autoritetet lokale prë krijimin e modeleve që mundësojnë kontributin pozitiv të emigrantëve në qytete dhe që forcojnë lidhjet urbane-rurale.

29. Ne angazhohemi të forcojmë rolin koordinues të qeverive qendrore, rajonale dhe lokale, sipas rastit, dhe bashkëpunimin e tyre me subjektet e tjera publike dhe organizatat joqeveritare, për ofrimin e shërbimeve sociale dhe shërbimeve bazë për të gjithë, duke përfshirë gjenerimin e investimeve në komunitetet që janë më të rrezikuara dhe më të prekura nga katastrofat natyrore dhe krizat humanitare aktuale dhe të zgjatura. Ne angazhohemi më tej që të promovojmë shërbime të përshtatshme, strehim, dhe mundësi për punë të denjë dhe produktive për personat e prekur nga krizat në vendbanimet urbane, duke punuar me komunitetet dhe qeveritë vendore për të identifikuar mundësitë për angazhimin dhe zhvillimin e zgjidhjeve lokale, të qëndrueshme dhe dinjitoze, duke u siguruar ndërkohë që ndihmat të shkojnë tek personat e cënuar dhe komunitetet pritëse për të parandaluar regresin në zhvillimin e tyre.

30. Ne jemi të ndërgjegjshëm për nevojën për mbështetje të shërbimeve urbane gjatë konflikteve të armatosura nga qeveritë dhe shoqëria civile. Ne pranojmë po ashtu dhe nevojën për të riafirmuar respektimin e plotë të së drejtës ndërkombëtare humanitare.

31. Ne angazhohemi që të promovojmë politika kombëtare, rajonale dhe vendore të strehimit që mbështesin realizimin progresiv të së drejtës për strehim të përshtatshëm për të gjithë, si pjesë përbërëse e të drejtës për një standard të përshtatshëm jetese, të cilat i trajtojnë të gjitha format e diskriminimit dhe të dhunës, parandalojnë dëbimet arbitrare të detyruara, dhe të përqëndrohen tek nevojat e të pastrehëve, personave në nevojë, grupeve me të ardhura të ulëta, dhe personave me aftësi të kufizuara, duke mundësuar pjesëmarrjen dhe angazhimin e komuniteteve dhe palëve të interesuara në planifikimin dhe zbatimin e këtyre politikave.

32. Ne angazhohemi të nxisim zhvillimin e politikave për strehim të integruar, të cilat i përgjigjen të gjitha moshave dhe gjinisë dhe qasjes në të gjithë sektorët, në veçanti në punësim, arsim, shëndetësi dhe sektorë të integritit social, dhe në të gjitha nivelet e qeverisë, të cilat përfshijnë ofrimin e strehimit të përshtatshëm, të përballueshëm, të arritshëm, të sigurt, fleksibël, të koordinuar dhe të pozicionuar mirë, duke i kushtuar vëmendje të veçantë faktorit të afërsisë dhe forcimit të marrëdhënieve hapësinore me pjesën tjetër të strukturës urbane dhe zonave funksionale përreth.

33. Ne angazhohemi të stimulojmë ofrimin e mundësive të shumëllojshme dhe të përshtatshme për strehim të sigurt, të përballueshëm dhe të arritshëm për grupet shoqërore me të ardhura të ndryshme, duke marrë parasysh integrimin socio-ekonomik dhe kulturor të komuniteteve të marxhinalizuara, personave të pastrehë, dhe të atyre që ndodhen në situata të cënueshme, duke parandaluar izolimin. Ne do të marrim masa pozitive për të përmirësuar kushtet e jetesës së njerëzve të pastrehë me qëllim lehtësimin e pjesëmarrjes së tyre të plotë në shoqëri.

34. Ne angazhohemi të sigurojmë akses të barabartë dhe të përballueshëm në një infrastrukturë të qëndrueshme, fizike dhe sociale për të gjithë, pa diskriminim, duke përfshirë edhe shërbimin e përballueshëm të tokës, strehimit, energjisë moderne dhe të rinovueshme, ujit të pijshëm të sigurt dhe kanalizimeve, ushqimeve të sigurt dhe të përshtatshme, hedhjen e mbeturinave, lëvizshmërinë e qëndrueshme, kujdesin shëndetësor dhe planifikimin e familjes, arsimin, kulturën dhe teknologjive të komunikimit dhe informacionit. Ne angazhohemi, po ashtu, të sigurojmë që

këto shërbime t'u përgjigjen të drejtave dhe nevojave të grave, fëmijëve dhe të rinjve, personave të moshuar dhe personave me aftësi të kufizuara, popullsisve indigjene dhe komuniteteve lokale, dhe personave të tjerë që janë në situata në nevojë, të tillë si refugjatët, personat e zhvendosur brenda vendit dhe migrantët. Në këtë drejtim, ne inkurajojmë mënjanimin e pengesave ligjore, institucionale, social-ekonomike, apo fizike.

35. Ne angazhohemi të promovojmë në nivelin e duhur të qeverisjes, përfshirë qeverisjen rajonale ose vendore, sigurinë në rritje për qëndrim për të gjithë, duke pranuar morinë e llojeve të pronësisë, dhe të zhvillojmë zgjidhje të tilla që i përgjigjen moshës, gjinisë dhe mjedisit brenda kuadrit të madhësisë së tokës dhe të drejtave të pronës, duke i kushtuar vëmendje të veçantë sigurisë së zotërimit të tokës për gratë si pikë kyçe për fuqizimin e tyre.


36. Ne angazhohemi të nxitim masat e duhura në qytete dhe vendbanime për të lehtësuar aksesin për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në mjedisin fizik të qyteteve, në mënyrë të veçantë në hapësirat publike, transportin publik, strehimin, arsimin dhe institucionet shëndetësore, të informimit dhe komunikimit publik, duke përfshirë teknologjinë dhe sistemet e informacionit dhe të komunikimit, si dhe në objektet dhe shërbime të tjera të hapura apo të ofruara për publikun, si në zonat urbane dhe në ato rurale.

37. Ne angazhohemi të promovojmë hapësira publike të sigurta, përfshirëse, të arritshme, të gjelbërta, dhe me cilësi, duke përfshirë rrugët, trotuaret dhe korsitë e çiklizmit, sheshet, zonat ujore, kopshtet dhe parqet që janë zona multifunksionale për ndërveprim dhe përfshirje sociale, shëndetin e njeriut dhe mirëqenien, shkëmbimin ekonomik dhe kulturor dhe dialogun mes një larmie të gjerë njerëzish dhe kulturash, të projektuara dhe të menaxhuara për të siguruar zhvillimin njerëzor, për të ndërtuar shoqëri paqësore, përfshirëse dhe pjesëmarrëse, si dhe për të nxitur të jetuarit së bashku, lidhjet dhe përfshirjen sociale.

38. Ne angazhohemi që të sigurojmë në mënyrë të qëndrueshme trashëgimitë natyrore dhe kulturore në qytetet dhe vendbanimet njerëzore, sipas rastit, si materiale dhe jomateriale, nëpërmjet politikave të integruara urbane dhe territoriale dhe investimeve të përshtatshme në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, për të mbrojtur dhe promovuar infrastrukturën kulturore, muzetë, kulturat indigjene dhe gjuhët, si dhe njohuritë tradicionale dhe artet, duke theksuar rolin që ato luajnë në rehabilitimin dhe ringjalljen e zonave urbane dhe si një mënyrë për të forcuar pjesëmarrjen sociale dhe ushtrimin e shtetësisë.

39. Ne angazhohemi të sigurojmë një mjedis të sigurt, të shëndetshëm, gjithëpërfshirës, dhe të sigurt në qytete dhe vendbanime që të gjithë të jetojnë, punojnë, dhe të marrin pjesë në jetën urbane, pa frikën e dhunës dhe kërcënimit, duke pasur parasysh se gratë, vajzat, fëmijët dhe të rinjtë janë shpesh dhe veçanërisht të prekur. Ne do të punojmë po ashtu dhe për të mënjанuar praktikatat dëmtuese ndaj grave dhe vajzave, fëmijëve, martesat e detyruara dhe gjymtimin gjenital të grave dhe vajzave.

Barcelona, Spanje



40. Ne angazhohemi të përfshijmë diversitetin në qytete dhe vendbanime për të forcuar kohezionin social, dialogun ndërkulturor dhe mirëkuptimin, tolerancën, respektin reciprok, barazinë gjinore, inovacionin, sipërmarrjen, përfshirjen, identitetin dhe sigurinë dhe dinjitetin e të gjithë njerëzve, si dhe për të nxitur mundësinë e të jetuarit dhe një ekonomi të gjallë urbane. Ne angazhohemi po ashtu dhe të sigurojmë që institucionet tona vendore të promovojnë bashkëjetesën paqësore dhe pluraliste brenda shoqërive gjithnjë e më heterogjene dhe shumëkulturore.

41. Ne angazhohemi të nxitim mekanizma institucionale, politike, ligjore dhe financiare në qytete dhe vendbanime për të zgjeruar platforma gjithëpërfshirëse, në përputhje me politika kombëtare që lejojnë pjesëmarrjen kuptimplotë në proceset e vendimmarrjes, planifikimit, dhe proceset pasuese për të gjithë, si dhe një angazhim të zgjeruar civil, bashkëofrim dhe bashkëprodhim.

42. Ne i mbështesim qeveritë rajonale dhe vendore, sipas rastit, në përbushjen e rolit të tyre kyç për forcimin e ndërveprimit midis të gjitha palëve të interesuara, duke ofruar mundësi për dialog, duke përfshirë përmes qasjes së përgjegjshme ndaj moshës dhe gjinisë, dhe duke i kushtuar vëmendje të veçantë kontributeve potenciale nga të gjitha segmentet e shoqërisë, duke përfshirë burrat dhe gratë, fëmijët dhe të rinjtë, personat e moshuar dhe personat me aftësi të kufizuara, popujt indigenë dhe komunitetet lokale, refugjatët dhe personat e zhvendosur brenda vendit dhe migrantët, pavarësisht nga statusi i migrimit, dhe pa diskriminim për shkak të racës, fesë, etnisë, apo statusit social-ekonomik.

Mirëqënia e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse urbane dhe mundësi për të gjithë

43. Ne e pranojmë se rritja ekonomike afatgjatë, e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, me një punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë, përbën një element kyç të zhvillimit të qëndrueshëm urban dhe territorial dhe se qytetet dhe vendbanimet duhet të jenë vende të mundësive të barabarta dhe t'u lejojnë njerëzve që të kenë jetesë të shëndetshme, produktive, të begatë, dhe të përbushur.

44. Ne e dimë se forma urbane, infrastruktura, dhe projektimi i ndërtimeve janë ndër shtytësit më të mëdhenj të efikasitetit të kostove dhe burimeve, përmes përfitimeve nga ekonomitë e shkallës dhe aglomerateve dhe nxitjes së efikasitetit të energjisë, energjisë së rinovueshme, fleksibilitetit, produktivitetit, mbrojtjes së mjedisit, dhe rritjes së qëndrueshme në ekonomitë urbane.

45. Ne angazhohemi të zhvillojmë ekonomi urbane të gjalla, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, duke u mbështetur në potencialet endogjene, avantazhet konkurruese, trashëgimitë kulturore dhe burimet lokale, si dhe burimet efikase dhe infrastrukturën elastike, nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës industrial, modelet e konsumit dhe prodhimit të qëndrueshëm, dhe duke nxitur një mjedis të përshtatshëm për bizneset, inovacionin, si dhe jetesën.

46. Ne angazhohemi të promovojmë rolin e strehimit të përbalueshëm dhe të qëndrueshëm dhe financimin e strehimit, duke përfshirë edhe prodhimin e habitatit social, në zhvillimin ekonomik, si dhe kontributin e sektorit për stimulimin e produktivitetit në sektorët e tjerë të ekonomisë,

duke pranuar se strehimit rrit formimin e kapitalit, të ardhurat, krijimin e vendeve të reja të punës dhe kursimet, dhe mund të kontribuojë për kanalizimin e transformimit të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës ekonomik në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.

47. Ne angazhohemi të marrim hapat e nevojshme për forcimin e institucioneve kombëtare, rajonale dhe lokale për të mbështetur zhvillimin ekonomik lokal, për të nxitur integrimin, bashkëpunimin, koordinimin, dhe dialogun në të gjithë nivelet e qeverive, zonave funksionale dhe palëve të interesuara.

48. Ne inkurajojmë pjesëmarrjen efektive dhe bashkëpunimin mes të gjitha palëve të interesuara, duke përfshirë qeveritë vendore, sektorin privat, shoqërinë civile, gratë dhe organizatat rinore, si dhe personat me aftësi të kufizuara, popujt indigjenë, profesionistët, institucionet akademike, sindikatat, organizatat e punëdhënësve, shoqatat e emigrantëve dhe shoqatat kulturore, në përcaktimin e mundësive për zhvillim ekonomik urban, si dhe në identifikimin dhe trajtimin e sfidave ekzistuese dhe atyre në të ardhmen.

49. Ne angazhohemi të mbështesim sisteme territoriale që integrojnë funksionet urbane dhe rurale në kornizat hapësinore kombëtare dhe rajonale dhe në sistemet e qyteteve dhe vendbanimeve, dhe të promovojmë menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe tokës, duke siguruar furnizim të besueshëm dhe zinxhirë vlere që lidhin ofertën dhe kërkesën urbane me ofertën dhe kërkesën rurale për të nxitur zhvillimin e barabartë rajonal përmes hapësirës urbano-rurale dhe për të ngushtuar hendekun social dhe ekonomik.

50. Ne angazhohemi të inkurajojmë lidhjet dhe ndërveprimet urbano-rurale duke forcuar transportin dhe lëvizshmërinë e qëndrueshme, rrjetet dhe infrastrukturën e teknologjisë dhe komunikimit, mbështetur nga instrumentet e planifikimit të bazuara në qasje të integruara urbane dhe territoriale, në mënyrë që të maksimizohet potenciali i këtyre sektorëve për rritjen e produktivitetit, kohezionit social, ekonomik dhe territorial, si dhe siguria dhe qëndrueshmëria e mjedisit. Kjo duhet të përfshijë lidhjen mes qyteteve dhe rrethinave të tyre, zonave periferike-urbane dhe rurale, si dhe lidhjet më të mëdha të tokës me det, kur është e përshtatshme.

51. Ne angazhohemi të nxitim zhvillimin e kornizave hapësinore urbane, duke përfshirë planifikimin urban dhe instrumentat e projektimit që mbështesin menaxhimin e qëndrueshëm dhe përdorimin e burimeve natyrore dhe tokës, kompaktësinë dhe dendësinë e duhur, policentrizmin dhe përdorimet mikse, përmes strategjive të planifikuara ose plotësuese të zgjerimit urban, sipas nevojës, për të gjeneruar ekonomitë e zgjerimit dhe aglomerimin, për të forcuar planifikimin e sistemit të ushqimit, për të rritur efikasitetin e burimeve, fleksibilitetin urban, dhe qëndrueshmërinë e mjedisit.

52. Ne inkurajojmë strategjitë e zhvillimit hapësinor që marrin parasysh, sipas rastit, nevojën për të drejtuar zgjerimin urban, duke planifikuar infrastrukturën dhe shërbimet, densitetin e qëndrueshëm të popullsisë, dhe integrimin e lagjeve (rrethinave) të reja në strukturën urbane.

53. Ne angazhohemi të promovojmë hapësira publike të sigurta, përfshirëse, të arritshme, të gjelbëra, dhe me cilësi si shtytëse të zhvillimit social dhe ekonomik, të cilat kontribuojnë në mënyrë të qëndrueshme për gjenerimin e vlerës së shtuar sociale dhe ekonomike, duke përfshirë edhe vlerën e pronës, dhe për të lehtësuar biznesin, investimet publike dhe private dhe mundësitë e jetesës për të gjithë.

54. Ne angazhohemi të inkurajojmë gjenerimin dhe përdorimin e energjive të rinovueshme dhe të përballueshme dhe një infrastrukturë dhe shërbime transporti të qëndrueshme dhe efikase, aty ku është e mundur, duke arritur përfitimet e konektivitetit dhe duke reduktuar kostot financiare, mjedisore, dhe të shëndetit publik të lëvizjeve joefikase, bllokimet e trafikut, ndotjen e ajrit, efektet e ngrohjes urbane dhe zhurmat. Ne angazhohemi po ashtu që t'i kushtojmë vëmendje të veçantë nevojave për energji dhe transport për të gjithë njerëzit, sidomos për të varfërit dhe për ata që jetojnë në vendbanime joformale. Ne theksojmë gjithashtu se reduktimi i shpenzimeve për shkak të përdorimit të energjisë së rinovueshme u jep qyteteve dhe vendbanimeve një mjet efikas për uljen e kostove të furnizimit me energji.

55. Ne angazhohemi të nxitim shoqëri të shëndetshme duke promovuar akses në shërbime publike të përshtatshme, gjithëpërfshirëse, dhe me cilësi, infrastrukturë dhe mjedise sociale, të tilla si shërbimet e kujdesit shëndetësor, duke përfshirë shërbimet e kujdesit shëndetësor seksual dhe riprodhues për të ulur vdekshmërinë foshnjore dhe të nënave.

56. Ne angazhohemi të rritim produktivitetin ekonomik, sipas rastit, duke i siguruar krahut të punës akses në mundësitë e fitimit të të ardhurave, njohuri, aftësi dhe mjedise arsimore që kontribuojnë për një ekonomi urbane inovatore dhe konkurruese. Ne angazhohemi po ashtu dhe për të rritur produktivitetin ekonomik përmes gjenerimit të punësimit të plotë dhe produktiv, punës së denjë, dhe mundësitë për jetesë në qytetet dhe vendbanimet tona.

57. Ne angazhohemi për nxitjen e punësimit të plotë dhe produktiv, punës së përshtatshme për të gjithë, dhe mundësive të jetesës në qytete dhe vendbanime, duke i kushtuar vëmendje të veçantë nevojave dhe potencialit të grave, të rinjëve, personave me aftësi të kufizuara, popujve indigjenë dhe komuniteteve lokale, refugjatëve dhe personave të zhvendosur, dhe migrantëve, sidomos më të varfërve dhe personave në situata të cënueshme, si dhe nxitjes së aksesit jodiskriminues në mundësitë për fitimin e të adhurave ligjore.

58. Ne angazhohemi të promovojmë një mjedis biznesi mundësues, të drejtë dhe përgjegjës, bazuar në parimet e qëndrueshmërisë mjedisore dhe mirëqenies gjithëpërfshirëse, nxitjes së investimeve, inovacionit, dhe sipërmarrjes. Ne angazhohemi po ashtu të trajtojmë sfidat me të cilat përballen komunitetet lokale të biznesit përmes mbështetjes së ndërmarrjeve të vogla e të mesme gjatë gjithë zinxhirit të vlerës, në veçanti bizneset dhe ndërmarrjet në ekonominë sociale dhe të solidaritetit, që veprojnë si në ekonominë formale ashtu dhe joformale.

59. Ne angazhohemi të njohim kontributin e të varfërve që punojnë në ekonominë informale, veçanërisht të grave, duke përfshirë edhe punonjësit e papaguar, atyre që punojnë në familje,

dhe të punëtorëve migrantë në ekonomitë urbane, duke marrë parasysh rrethanat kombëtare. Kushtet e jetesës dhe punës dhe siguria e të ardhurave, mbrojtja ligjore dhe sociale, aftësitë, aksesit tek asetet dhe shërbimet e tjera mbështetëse, si dhe zëri dhe përfaqësimi i tyre duhet të zgjerohen dhe të përmirësohen. Kalimi progresiv i punonjësve dhe njësive ekonomike tek ekonomitë formale do të zhvillohet duke përqafuar një qasje të balancuar, duke kombinuar stimuj dhe masa të pajtueshmërisë, si dhe duke promovuar në të njëjtën kohë ruajtjen dhe përmirësimin e jetesës ekzistuese. Ne do të marrim parasysh rrethanat, legjisllacionin, politikat, praktikat, dhe përparësitë specifike kombëtare për kalimin tek ekonomia formale.

60. Ne angazhohemi të mbështesim ekonomitë urbane drejt tranzicionit progresiv për produktivitet më të lartë nëpërmjet sektorëve me vlerë të shtuar të lartë, duke promovuar diversifikimin, përmirësimin teknologjik, kërkimin dhe inovacionin, duke përfshirë, ndërjetet të tjerash, krijimin e vendeve të punëve me cilësi, të denja, dhe produktive, promovimin kulturor dhe të industrive krijuese, turizmin e qëndrueshëm, artet interpretative, dhe aktivitetet e ruajtjes së trashëgimisë.

61. Ne angazhohemi të shfrytëzojmë dividendin urban demografik, sipas rastit, dhe të promovojmë aksesin në arsim për të rinjtë, zhvillimin e aftësive dhe punësimin për të arritur një produktivitet në rritje dhe prosperitet të përbashkët në qytetet dhe vendbanimet tona. Vajzat dhe djemtë, gratë e reja dhe të rinjtë, janë agjentë kryesorë të ndryshimeve për krijimin e një të ardhmeje më të mirë dhe, kur fuqizohen, ata kanë potencial të madh për të të siguruar mbështetje në emër të tyre dhe të komuniteteve që përfaqësojnë. Sigurimi i mundësive më të shumëta dhe më të mira për pjesëmarrjen e tyre kuptimplotë është thelbësor për zbatimin e Axtendës së Re Urbane.

62. Ne angazhohemi të trajtojmë pasojat sociale, ekonomike dhe hapësinore të popullsisë në plakje, sipas rastit, dhe të shfrytëzojmë faktorin e plakjes si mundësi për vende pune të reja, të denja dhe të qëndrueshme, për rritje ekonomike gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, duke përmirësuar cilësinë e jetës së popullsisë urbane.

Zhvillim urban fleksibël dhe ekologjikisht i qëndrueshëm

63. Ne e dimë që qytetet dhe vendbanimet përballen me kërcënime të paparashikuara nga modele të paqëndrueshme konsumi dhe prodhimi, humbja e biodiversitetit dhe presioni mbi ekosistemet, ndotja, dhe fatkeqësitë natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu, si dhe ndryshimet klimatike dhe rreziqet e lidhura me të, duke minuar përpjekjet për t'i dhënë fund varfërisë në të gjitha format dhe dimensioned, dhe për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm. Tendencat demografike të qyteteve të caktuara dhe roli i tyre qendror në ekonominë globale në përpjekjet e zbutjes dhe përshtatjes që lidhen me ndryshimet klimatike dhe me përdorimin e burimeve dhe ekosistemeve, dhe mënyra se si planifikohen, financohen, zhvillohen, ndërtohen, qeverisen dhe menaxhohen ato kanë ndikim të drejtpërdrejtë mbi qëndrueshmërinë dhe elasticitetin edhe përtej kufijve urbanë.

64. Ne pranojmë po ashtu se qendrat urbane në të gjithë botën, veçanërisht në vendet në zhvillim, shpesh kanë karakteristika që i bëjnë ato dhe banorët e tyre veçanërisht të pambrojtur ndaj ndikimeve negative të ndryshimeve klimatike dhe rreziqeve të tjera natyrore dhe të shkaktuara nga

njeriu, duke përfshirë edhe ngjarjet e motit ekstrem, përmbytjet, rrëshqitjet, stuhitë, duke përfshirë stuhitë e pluhurit dhe të rërës, valët e të nxehtit, mungesën e ujit, thatësinë, ndotjen e ujit dhe të ajrit, sëmundjet e transmetueshme, dhe rritjen e nivelit të detit që në veçanti prekin, ndër të tjera, zonat bregdetare, rajonet delta, dhe shtete e vegjël ishullorë në zhvillim.

65. Ne angazhohemi të lehtësojmë menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore në qytete dhe vendbanime në mënyrë të tillë që të mbrohet dhe përmirësohet ekosistemi urban dhe shërbimet mjedisore, të reduktohen emetimet e gazrave dhe ndotja e ajrit, si dhe të promovohet ulja dhe menaxhimi i rrezikut nga fatkeqësitë, nëpërmjet zhvillimit të strategjive dhe vlerësimeve periodike për uljen e rreziqeve nga fatkeqësitë e shkaktuara nga natyra dhe nga njeriu, përfshirë dhe standardet për nivelin e rreziqeve, nderkohë që nxitet zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm, duke mbrojtur mirëqenien dhe cilësinë e jetës për të gjithë njerëzit, përmes planifikimit urban dhe territorial ekologjikisht të shëndoshtë, infrastrukturës dhe shërbimeve bazë.

66. Ne angazhohemi të përdorim një qasje të qytetit inteligjent, i cili i bën të përdorshme mundësitë që rrjedhin nga dixhitalizimi, energjia e pastër dhe teknologjia, si dhe teknologjitë e reja të transportit, duke siguruar mundësi për banorët për të bërë më shumë zgjedhje miqësore për mjedisin dhe për të nxitur rritjen e qëndrueshme ekonomike.

67. Ne angazhohemi të nxitim krijimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve të hapësirave publike të hapura, shumëqëllimshme, të sigurta, përfshirëse, të arritshme, të gjelbërta, dhe me cilësi për të përmirësuar elasticitetin e qyteteve ndaj fatkeqësive dhe ndryshimeve klimatike, reduktimin e rreziqeve të përmbytjeve dhe thatësisë dhe valëve të nxehtësisë, dhe përmirësimin e sigurisë së ushqimit dhe të ushqyerit, shëndetin fizik dhe mendor, dhe cilësinë e ajrit të ambientit dhe pajisjeve shtëpiake, reduktimin e zhurmës, dhe promovimin e qyteteve dhe vendbanimeve tërheqëse dhe peizazheve urbane, me proritete ruajtjen e specieve endemike.

68. Ne angazhohemi t'i kushtojmë vëmendje të veçantë zonave urbane me dalje në det, zonave bregdetare, si dhe zonave të tjera të ndjeshme për mjedisin, duke theksuar rëndësinë e tyre si ofrues të ekosistemeve të burimeve të rëndësishme për transportin, sigurimin e ushqimit, mirëqenien ekonomike, shërbimet e ekosistemit dhe elasticitetin, dhe integrimin e masave të duhura për t'i faktorizuar ato në planifikimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm urban dhe territorial.

69. Ne angazhohemi të ruajmë dhe të nxitim funksionin ekologjik dhe social të vendit, përfshirë zonat bregdetare të cilat mbështesin qytetet dhe vendbanimet njerëzore, dhe të nxitim zgjidhje të ekosistemit për të siguruar modele të qëndrueshme të konsumit dhe të prodhimit, në mënyrë që të mos tejkalohet kapaciteti rigjenerues i ekosistemit. Ne angazhohemi po ashtu që të nxitim përdorimin e qëndrueshëm të tokës, duke kombinuar zgjerimet urbane me dendësi të përshtatshme, kompaktësinë për të parandaluar dhe ruajtur shtrirjen urbane, si dhe për të parandaluar humbjen e tokës prodhuese dhe ekosistemeve të brishta dhe të rëndësishme.

70. Ne angazhohemi të mbështesim ofrimin lokal të mallrave dhe shërbimeve bazë, duke favorizuar burimet e afërta, duke pranuar se mbështetja e madhe tek burimet e largëta të energjisë, ujit,

ushqimeve, dhe materialeve mund të paraqesin sfida lidhur me qëndrueshmërinë, duke përfshirë edhe dobësi në shërbim, ndërprerje të furnizimit, dhe që furnizimi lokal mund të mundësojë akses më të mirë për tek burimet banorët.

71. Ne angazhohemi të forcojmë menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve, duke përfshirë tokën, ujin (oqeanet, detet dhe ujëra e ëmbla), energjinë, materialet, pyjet, dhe ushqimet, duke i kushtuar vëmendje të veçantë administrimit të ambientit dhe minimizimit të të gjitha mbeturinave, kimikateve të rrezikshme, ndotësve, gazeve serë, dhe zhurmave, në mënyrë të tillë që merr parasysh lidhjet urbane-rurale, furnizimin funksional dhe zinxhirët e vlerës përballë ndikimit mjedisor dhe qëndrueshmërisë, dhe përpjekjeve për kalimin në një ekonomi ciklike, ndërsa lehtësojmë ruajtjen e ekosistemeve, rigjenerimin, ruajtjen, dhe elasticitetin e tyre përballë sfidave të reja dhe në zhvillim.

72. Ne angazhohemi për procese afatgjata të planifikimit urban dhe territorial dhe për praktika të zhvillimit hapësinor që përfshijnë planifikimin dhe menaxhimin e integruar të burimeve ujore, duke pasur parasysh vazhdimësinë urbane-rurale në shkallë lokale dhe territoriale, duke përfshirë pjesëmarrjen e aktorëve dhe komuniteteve përkatëse.

73. Ne angazhohemi të promovojmë ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të ujit duke rehabilituar burimet ujore në zonat periurbane dhe rurale, reduktimin dhe trajtimin e ujërave të zeza, duke minimizuar humbjet e ujit, duke promovuar ripërdorimin e ujit, rritjen e magazinimit, mbajtjen dhe ripërdorimin e ujit, duke marrë parasysh ciklin e tij.

74. Ne angazhohemi të promovojmë menaxhimin e shëndoshë mjedisor të ujërave të ndotura dhe të reduktojmë ndjeshëm prodhimin e mbetjeve, ripërdorimin dhe riciklimin (3RS) e mbetjeve, duke minimizuar vend-depozitet, dhe duke i konvertuar mbetjet në energji kur ato nuk mund të riciklohen, ose kur ky proces sjell rezultatin më të mirë mjedisor. Ne angazhohemi më tej të ulim nivelin e ndotjes detare përmes përmirësimit të menaxhimit të mbetjeve në zonat bregdetare.

75. Ne angazhohemi t'i mbështesim qeveritë rajonale dhe lokale, sipas rastit, për të zhvilluar modele ndërtimi dhe ndërtesa të qëndrueshme, të rinovueshme, me furnizim të përbalueshëm me energji dhe ndërtime dhe mënyra ndërtimi me energji eficiente, të cilat janë thelbësore për të mundësuar reduktimin e emetimit të gazrave serë dhe të karbonit të zi, për të arritur modele të qëndrueshme konsumi dhe prodhimi, dhe për të krijuar vende pune të reja dhe të denja, për të përmirësuar shëndetin publik dhe për të zvogëluar shpenzimet e furnizimit me energji.

76. Ne angazhohemi t'i përdorim në mënyrë të qëndrueshme burimet natyrore dhe të përqendrohemi tek efica e burimeve të lëndëve të para dhe materialeve të ndërtimit, të tilla si betoni, metalet, druri, mineralet, dhe toka, të krijojmë ripërdorim të sigurt të materialeve dhe produkteve të riciklimit, dhe të nxisim zhvillimin e ndërtimeve të qëndrueshme dhe fleksibël, duke i dhënë prioritet përdorimit të materialeve lokale, jotoksike dhe të riciklueshme, veshjeve dhe ngjyrave pa material shtesë plumbi.



77. Ne angazhohemi të forcojmë qëndrueshmërinë e qyteteve dhe vendbanimeve, duke përfshirë zhvillimin e cilësisë së infrastrukturës dhe planifikimit hapësinor përmes miratimit dhe zbatimit të politikave dhe planeve të integruara dhe të përshtatshme për të gjitha moshat dhe gjinitë, në përpunje me Kornizën Sendai për Reduktimin e Rrezikut të Katastrofave 2015-2030, integrimin gjithëpërfshirës dhe të dhëna të plota për reduktimin dhe menaxhimin e rreziqeve ndaj fatkeqësive në të gjitha nivelet, reduktimin e cënueshmërisë dhe rrezikut, veçanërisht në zonat me rrezik në vendbanimet formale dhe joformale, përfshirë lagjet e varfra, duke u mundësuar familjeve, komuniteteve, institucioneve dhe shërbimeve të përgatiten, përgjigjen, përshtaten dhe të rimarrin veten me shpejtësi përballë efekteve të rreziqeve, duke përfshirë goditjet apo streset e fshehura. Ne do të nxisim zhvillimin e infrastrukturës elastike, me burime eficiente, e cila do të zvogëlojë rreziqet dhe ndikimin e fatkeqësive, duke përfshirë edhe lagjet e varfëra dhe vendbanimet joformale.

78. Ne angazhohemi të mbështesim kalimin nga qasje reaguese tek një qasje më aktive e bazuar tek rreziqet, një qasje që i përfshin të gjitha rreziqet dhe të gjithë shoqërinë, duke përfshirë rritjen e ndërgjegjësimit të publikut mbi rrezikun dhe nxitjen e investimeve pas ngjarjeve (ex-ante) për të parandaluar rreziqet dhe për të ndërtuar elasticitetin, edhe për të siguruar përgjigje lokale në kohë dhe efektive, për të trajtuar nevojat e menjëhershme të banorëve të prekur nga fatkeqësitë natyrore, fatkeqësitë e shkaktuara nga njeriu, dhe nga konfliktet. Kjo duhet të përfshijë integrimin e parimeve "Build Back Better/ndërto më mirë më pas" në procesin e rimëkëmbjes pas katastrofave për të integruar ndërtesa fleksibël, masat mjedisore dhe hapësina të përshtatshme, duke nxjerrë mësim nga fatkeqësitë e kaluara dhe duke rritur ndërgjegjësimin për rreziqet e reja në planifikimin e ardhshëm.

79. Ne angazhohemi të nxitim aksionin klimatik ndërkombëtar, kombëtar, rajonal dhe lokal, duke përfshirë përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike, dhe të mbështesim qytetet dhe vendbanimet, banorët e tyre dhe të gjithë aktorët locale si zbatuesit kryesorë. Ne angazhohemi gjithashtu që të mbështesim ndërtimin e fleksibilitetit dhe reduktimin e emetimeve të gazrave serë, si dhe emetimet e ndotësve klimatikë nga të gjithë sektorët përkatës. Masa të tilla duhet të jenë në përputhje me qëllimet e Marrëveshjes së Parisit të miratuar në kuadër të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimin e Klimës, duke përfshirë mbajtjen e rritjes së temperaturës mesatare globale nën 2 gradë Celsius mbi nivelet paraindustriale, dhe duke vijuar përpjekjet për të kufizuar rritjen e temperaturës në 1.5 gradë Celsius në nivelet paraindustriale.

80. Ne angazhohemi të mbështetim procesin e planifikimit afatmesëm dhe afatgjatë të adaptimit, si dhe cënueshmërinë dhe vlerësimin e ndikimit klimatik në nivel qyteti, të japim informacion për planet, politikat, programet dhe masat e përshtatjes, të cilat formësojnë fleksibilitetin e banorëve urbane, duke përfshirë përdorimin e përshtatjes bazuar në ekosistem.

Zbatimi me efektivitet i axhendës

81. Ne jemi të vetëdijshëm se realizimi i angazhimeve transformuese të përcaktuara në Axhendën e Re Urbane kërkon një kuadër politikash të mundshme në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, të integruara përmes planifikimit dhe menaxhimit të zhvillimit hapësinor urban, dhe mjete efektive për zbatimin, të plotësuara nga bashkëpunimi ndërkombëtar dhe nga përpjekjet për zhvillimin e kapaciteteve, duke përfshirë shkëmbimin e praktikave, politikave dhe programeve më të mira ndërmjet qeverive në të gjitha nivelet.

82. Ne i ftojme organizatat ndërkombëtare dhe rajonale, duke përfshirë sistemin e Kombeve të Bashkuara, partnerët e zhvillimit, institucionet financiare ndërkombëtare dhe shumëpalëshe, bankat e zhvillimit rajonal, sektorin privat dhe aktorët e tjerë, që të rrisin koordinimin e strategjive urbane dhe programeve të zhvillimit për të aplikuar një qasje të integruar të urbanizimit të qëndrueshëm, duke harmonizuar zbatimin e Axhendës së Re Urban.

83. Në këtë kuadër, ne theksojmë nevojën për përmirësimin e koordinimit dhe koherencës në mbarë sistemin e Kombeve të Bashkuara në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm urban, brenda kornizës së planifikimit strategjik, zbatimit dhe raportimit në mbarë sistemin, siç theksohet në paragrafin 88 të Axhendës për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030.

84. Ne i nxisim fuqimisht shtetet të shmangin shpalljen dhe zbatimin e çdo mase të njëanshme ekonomike, financiare, ose tregtare që nuk është në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe pengon arritjen e plotë të zhvillimit ekonomik dhe social, veçanërisht në vendet në zhvillim.

Ndërtimi i strukturës së qeverisjes urbane: krijimi i një kornize mbështetëse

85. Ne i pranojmë parimet dhe strategjitë që përfshihen në Udhëzimet Ndërkombëtare mbi Decentralizimin dhe Forcimin e Pushtetit Lokal dhe Udhëzimet Ndërkombëtare mbi Aksesin në Shërbimet Bazë për të Gjithë, miratuar nga Këshilli Drejtues i UN-Habitat në rezolutën 21/3 të 20 Prillit 2007¹⁵ dhe 22/ të 3 Prillit 2009¹⁶.

86. Ne do të mbështesin zbatimin efektiv të Axhendës së Re Urbane në politikat urbane gjithëpërfshirëse, të zbatueshme, dhe pjesëmarrëse, sipas rastit, për zhvillimin e rregullt e të qëndrueshëm urban dhe territorial, si pjesë e strategjive dhe planeve zhvillimore të integruara, të mbështetura, sipas rastit, nga kuadri rregullator dhe institucional kombëtar, rajonal dhe lokal, duke siguruar që ato të jenë të lidhura si duhet me mekanizma financiarë transparente dhe llogaridhënëse.

87. Ne do të nxisim koordinimin dhe bashkëpunimin e fortë ndërmjet qeverive kombëtare, rajonale dhe vendore, nëpërmjet mekanizmave të konsultimit dhe përcaktimit të qartë të kompetencave, mjeteve dhe burimeve përkatëse për çdo nivel qeverisjeje.

¹⁵ Shih Protokollet Zyrtare të Asamblesë së Përgjithshme, Suplementi Nr. 8 (A/62/8), annex I.

¹⁶ Ibid., Sesioni i gjashtedhejtë e kater, Suplementi Nr. 8 (A/64/8), annex I.



88. Ne do të promovojmë koherencën mes qëllimeve dhe masave të politikave sektoriale, duke përfshirë zhvillimin rural, përdorimin e tokës, sigurimin e ushqimit, menaxhimin e burimeve natyrore, ofrimin e shërbimeve publike, ujin dhe kanalizimet, mjedisin, energjinë, politikat e strehimit dhe lëvizjeve, në nivele dhe shkallë të ndryshme të administratës politike, përtej kufijve administrativë, dhe duke pasur parasysh zonat urbane funksionale përkatëse, në mënyrë që të forcohet qasja e integruar ndaj urbanizimit dhe të zbatohen strategji të planifikimit të integruar urban dhe territorial që e reflektojnë atë.

89. Ne do të marrim masa për të krijuar kuadre ligjore dhe të politikave duke u bazuar në parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit, për t'u mundësuar autoriteteve vendore të zbatojnë në mënyrë efektive politikat kombëtare urbane, sipas nevojave, dhe për t'i fuqizuar ato si struktura politikëbërëse dhe vendimmarrëse, duke siguruar decentralizim fiskal, politik dhe administrativ të përshtatshëm, në bazë të parimit të subsidiaritetit.

90. Ne do të mbështesin forcimin e kapaciteteve të qeverive rajonale dhe vendore për zbatimin efektiv të qeverisjes vendore dhe metropolitane shumë-nivelëshe, përtej kufijve administrativë, dhe të bazuar në territore funksionale, duke siguruar përfshirjen në vendimmarrje të qeverive rajonale dhe vendore, duke u ofruar atyre autoritetet dhe burimet e nevojshme për të menaxhuar çështje kritike urbane, metropolitane, dhe territoriale. Ne do të promovojmë qeverisjen metropolitane gjithëpërfshirëse dhe që përqafojnë kuadre ligjore dhe mekanizma financiarë të besueshëm, duke përfshirë menaxhimin e qëndrueshëm të borxhit, sipas rastit. Ne do të marrim masa për të siguruar pjesëmarrje të plotë dhe efektive të grave, të drejta të barabarta për to në të gjitha fushat dhe udhëheqje në të gjitha nivelet e vendimmarrjes, përfshirë dhe qeveritë vendore.

91. Ne do t'i mbështesim qeveritë vendore për të përcaktuar strukturat e tyre administrative dhe menaxhuese, në përputhje me legjislacionin dhe politikat kombëtare, sipas rastit, në mënyrë që ato të përshtaten me nevojat lokale. Ne do të inkurajojmë kornizat e duhura rregullatore dhe do të mbështesim qeveritë lokale në partneritetin me komunitetet, shoqërinë civile dhe sektorin privat për të zhvilluar dhe për të menaxhuar shërbimet dhe infrastrukturën bazë duke siguruar ruajtjen e interesit publik dhe përcaktimin e qëllimeve, përgjegjësisë dhe mekanizmave koncize të logaridhënies.

92. Ne do të promovojmë qasje pjesëmarrëse në përgjigje ndaj moshës dhe gjinisë në të gjitha fazat e politikave urbane dhe territoriale dhe proceset e planifikimit, nga konceptimi deri tek projektimi, buxhetimi, zbatimi, monitorimi, vlerësimi dhe rishikimi, të rrënjësura në forma të reja të partneritetit të drejtpërdrejtë ndërmjet qeverive në gjitha nivelet dhe shoqërisë civile, duke përfshirë edhe mekanizmat e përhershëm të bazuar në kufijtë dhe përdorimin e mirë të burimeve dhe platformave për bashkëpunim dhe konsultimin e hapur për të gjithë, duke përdorur teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit dhe zgjidhje të aksesueshme të të dhënave.

Planifikimi dhe menaxhimi i zhvillimit hapësinor urban

93. Ne i pranojmë parimet dhe strategjitë e planifikimit urban dhe territorial të përfshira në Udhëzimet Ndërkombëtare mbi Planifikimin Urban dhe Territorial, të miratuara nga Këshilli Drejtues i UN-Habitat-it në rezolutën e tij 25/6 gjatë sesionit të 23 Prillit 2015¹⁷.

94. Ne do të zbatojmë një planifikim të integruar që ka për qëllim të balancojë nevojat afatshkurtra me rezultatet e dëshiruara afatgjata të një ekonomie konkurruese, nivel jetese me cilësi të lartë, dhe mjedis të qëndrueshëm. Ne do të përiqemi po ashtu të ndërtojmë me fleksibilitet planet tona, në mënyrë që ato të përshtaten me ndryshimet e kushteve sociale dhe ekonomike që ndodhin me kalimin e kohës. Ne do t'i zbatojmë dhe vlerësojmë sistematikisht këto plane, duke bërë përpjekje për të nxitur inovacionin në teknologji dhe për të prodhuar një mjedis jetese më të mirë.

95. Ne do të mbështesim zbatimin e politikave dhe planeve të zhvillimit territorial që janë integruese, policentrike, dhe të balancuara, duke inkurajuar bashkëpunimin dhe mbështetjen reciproke ndërmjet shkallëve të ndryshme të qyteteve dhe vendbanimeve, duke forcuar rolin e qyteteve të vogla dhe të ndërmjetme për të përmirësuar sistemin e sigurisë ushqimore dhe të ushqyerit, duke siguruar akses për strehim infrastrukturë dhe shërbime të qëndrueshme, të përballueshme, të përshtatshëm, elastik dhe të sigurta, dhe për të lehtësuar lidhjet efektive tregtare ndërmjet vijmësisë urbane-rurale, duke siguruar që fermerët e vegjël dhe peshkatarë janë të lidhur me zinxhirët e vlerës dhe tregjet lokale, rajonale, kombëtare, ndër-rajonale dhe globale. Ne do t'i mbështesim po ashtu bujqësinë urbane dhe fermat, konsumin dhe prodhimin e qëndrueshëm e të përgjegjshëm lokal, si dhe ndërveprimet sociale, duke mundësuar rrjete të aksesueshme të tregjeve dhe tregtisë lokale si mundësi për të kontribuar për qëndrueshmërinë dhe sigurinë e ushqimit.

96. Ne do të inkurajojmë zbatimin e planifikimit të qëndrueshëm urban dhe territorial, duke përfshirë planet për qytet-rajonet dhe planet metropolitane, për të inkurajuar sinergjinë dhe ndërveprimet ndërmjet zoneve urbane të të gjitha madhësive, dhe rrethinave të tyre periferike-urbane dhe rurale, duke përfshirë edhe zonat ndërkufitare dhe mbështetjen e zhvillimit të projekteve të qëndrueshme të infrastrukturës rajonale që nxisin produktivitetin e qëndrueshëm ekonomik, rritjen e barabartë ndërmjet rajoneve urbane dhe rurale. Në këtë drejtim ne do të promovojmë partneritetet urbane-rurale dhe mekanizmat e bashkëpunimit ndërbashkiak të bazuara në territore funksionale dhe zonat urbane si instrumente efikase për të kryer detyrat administrative bashkiake dhe metropolitane, për të ofruar shërbime publike, dhe për të nxitur zhvillimin lokal dhe rajonal.

97. Ne do të promovojmë zgjerimet dhe mbushjet e planifikuara urbane, duke përcaktuar përparësitë e rinovimit, rigjenerimit dhe riparimit të zoneve urbane, sipas rastit, duke përfshirë përmirësimin e lagjeve të varfëra dhe vendbanimeve joformale, duke nxitur qasje të integruara dhe me pjesëmarrje që përfshijnë të gjithë aktorët dhe banorë, duke shmangur segregimin dhe gjenifikimin hapësinor dhe social-ekonomik ndërsa ruajmë trashëgiminë kulturore dhe parandalojmë dhe përmbajmë shtrirjen urbane.

¹⁷ Ibid., Sesioni i Shtatëdhjetë, Suplementi Nr. 8 (A/70/8), aneks

98. Ne do të promovojmë planifikimin e integruar urban dhe territorial, duke përfshirë zgjerimet e planifikuara urbane bazuar në parimet e përdorimit të barabartë, eficient dhe të qëndrueshëm të tokës dhe burimeve natyrore, kompaktësinë, policentrizmin, dendësinë, përdorimin e shumëfishtë të hapësirës, si dhe përdorimet e përziera sociale dhe ekonomike në zonat e ndërtuara, për të parandaluar shtrirjen urbane, për të reduktuar sfidat dhe nevojat për lëvizshmëri, kostot për frymë të ofrimit të shërbimeve, dhe për të kontrolluar dendësinë, ekonominë e shkallës dhe aglomeratet.

99. Ne do të mbështesim zbatimin e strategjive të planifikimit urban dhe territorial që mundësojnë një përzjerje sociale përmes ofrimit të mundësive për strehim të përbalueshëm me akses në shërbime kryesore cilësore dhe hapësira publike për të gjithë, duke nxitur rritjen e sigurisë dhe sigurimit, favorizimin e ndërveprimit social dhe midis brezave dhe vlerësimin e diversitetit. Ne do të marrim hapa për të përfshirë trajnime dhe mbështetje të përshtatshme për profesionistët që ofrojnë shërbimet dhe për komunitetet që jetojnë në zonat e prekura nga dhuna urbane.

100. Ne do të mbështesim sigurimin e rrjeteve të mirëprojektuara të rrugëve të sigurta, të arritshme, të gjelbërta dhe cilësore, dhe të hapësirave të tjera publike të cilat janë të aksesueshme për të gjithë, pa krim dhe dhunë, duke përfshirë ngacmimin seksual dhe dhunën me bazë gjinore, duke marrë parasysh shkallën humane dhe masat që lejojnë përdorimin komercial më të mirë të mundshëm të kateve përdhese, nxitjen e tregjeve lokale formale dhe joformale, si dhe iniciativat jofitimprurëse të komunitetit, duke afruar njerëzit tek hapësirat publike, duke promovuar ecjen dhe çiklizmin për të përmirësuar shëndetin dhe mirëqenien.

101. Ne do të integrojmë reduktimin e rrezikut ndaj fatkeqësive, përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe lehtësimin e masave në përputhje me moshën dhe gjininë në proceset e planifikimit dhe zhvillimit urban dhe territorial, duke përfshirë emetimet e gazit serë, të bazuar në elasticitet, dhe projektim efektiv të klimës për hapësirat, ndërtesat, dhe ndërtimet, shërbimet dhe infrastrukturën, dhe zgjidhjet e bazuara në natyrë. Ne do të promovojmë bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet të gjithë sektorëve, si dhe do të rrisim kapacitetet e autoriteteve vendore për të zhvilluar dhe zbatuar reduktimin e rreziqeve nga fatkeqësitë dhe planet e përgjigjes ndaj fatkeqësitë, të tilla si vlerësimet e rreziqeve lidhur me vendndodhjen e objekteve publike aktuale dhe të ardhshme, dhe formulimet e procedurave të përshtatshme të emergjencave dhe të evakuimeve.

102. Ne do të përpiqemi të përmirësojmë kapacitetet për planifikimin dhe projektimin urban dhe të ofrojmë trajnim për planifikuesit urbanë në nivelet kombëtare, rajonale dhe vendore.

103. Ne do të integrojmë masa përfshirëse për sigurinë urbane dhe parandalimin e krimit dhe dhunës, përfshirë terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm që çon në terrorizëm. Këto masa, kurdo që është e mundur, do të përfshijnë komunitetet përkatëse lokale dhe akorët joqeveritarë në zhvillimin e strategjive dhe iniciativave urbane, duke përfshirë marrjen parasysh të lagjeve të varfëra dhe vendbanimeve joformale, si dhe faktorët e cenusshmërisë dhe ato kulturorë në zhvillimin e politikave që kanë të bëjnë me sigurinë publike dhe parandalimin e krimit dhe dhunës, duke përfshirë parandalimin dhe luftën kundër stigmatizimin e grupeve të caktuara për rrezikshmëri të lartë ndaj sigurisë.

104. Ne do të promovojmë respektimin e kërkesave ligjore me anë të kornizave të forta të menaxhimit gjithëpërfshirës dhe institucioneve përgjegjëse që merren me regjistrimin dhe qeverisjen e tokës, duke aplikuar një menaxhim dhe përdorim toke transparent dhe të qëndrueshëm, regjistrimin e pronës, dhe një sistemin të shëndoshë financiar. Ne do t'i mbështesim qeveritë vendore dhe palët e interesuara, përmes një shumëllojshmërie mekanizmesh, për zhvillimin dhe përdorimin e informacionit bazë të inventarit të tokës, të tillë si kadastrën, vlerësimin dhe hartat e rrezikut, si dhe të dhënat për çmimet e tokës dhe banesave për të gjeneruar të dhëna me cilësi të lartë, në kohë, dhe të besueshme sipas të ardhurave, gjinisë, moshës, racës, përkatësisë etnike, statusit të migrimit, aftësisë së kufizuar, vendndodhjes gjeografike, dhe karakteristika të tjera të rëndësishme në kontekstin kombëtar, të nevojshme për të vlerësuar ndryshimet në vlerat e tokës, duke siguruar se këto të dhëna nuk do të përdoren për politika diskriminuese në përdorimin e tokës.

105. Ne do të nxisim realizimin progresiv të së drejtës për strehim të përshtatshëm, si pjesë përbërëse e së drejtës për një standard të përshtatshëm jetese. Ne do të zhvillojmë dhe zbatojmë politika të strehimit në të gjitha nivelet, duke përfshirë planifikimin me pjesëmarrje, dhe duke aplikuar parimin e subsidiaritetit, sipas nevojës, për të siguruar koherencë mes strategjive të zhvillimit kombëtar, rajonal dhe vendor, politikave të tokës, dhe ofrimit të strehimit.

106. Ne do të promovojmë politika strehimi të bazuara në parimet e përfshirjes sociale, efektivitetit ekonomik dhe mbrojtjes së mjedisit. Ne do të rrisim përdorimin efektiv të burimeve publike për strehim të përbalueshëm dhe të qëndrueshëm, duke përfshirë tokën në zonat qendrore dhe të konsoliduara të qyteteve me infrastrukturë të përshtatshme, dhe do të inkurajojmë zhvillimin me të ardhura të përziera për të nxitur përfshirjen dhe kohezionin social.

107. Ne do të nxisim zhvillimin e politikave, mjeteve, mekanizmave dhe modeleve të financimit që promovojnë akses në një gamë të gjerë mundësish për strehim të përbalueshëm dhe të qëndrueshëm, duke përfshirë qiratë dhe opsione të tjera strehimi, si dhe zgjidhje bashkëpunuese të tilla si banimi i përbashkët, besimi i tokës nga komuniteti, dhe forma të tjera të strehimit të përbashkët, të cilat do të trajtojnë nevojat e personave dhe komuniteteve, për të përmirësuar ofrimin e strehimit, veçanërisht për grupet me të ardhura të ulëta, dhe për të parandaluar izolimin, dëbimet dhe zhvendosjet arbitrare me forcë, duke garantuar sigurimin e rivendosjes me dinjitet dhe në mënyrë të përshtatshme. Kjo do të përfshijë mbështetjen për strehim gradual dhe skemën e strehimit me ndërtim vetjak, duke i kushtuar vëmendje të veçantë programeve të përmirësimit të lagjeve të varfëra dhe vendbanimeve joformale.

108. Ne do të mbështesim zhvillimin e politikave të strehimit që forcojnë qasjet e strehimit të integruar lokal duke trajtuar lidhjet e forta ndërmjet arsimit, punësimit, strehimit dhe shëndetit, duke parandaluar përjashtimin dhe segregimin. Për më tej, ne angazhohemi të luftojmë mbetjen pa strehë dhe eliminimin e kriminalizimit të saj përmes politikave të dedikuara dhe strategjive të përcaktuara përfshirëse dhe aktive, të tilla si programet e strehimit parësor, përfshirëse dhe të qëndrueshme.

109. Ne do të mbështesim shpërndarjen në rritje të burimeve financiare dhe njerëzore për përmirësimin dhe, për aq sa të jetë e mundur, parandalimin e lagjeve të varfëra dhe vendbanimeve joformale me strategji që shkojnë përtej përmirësimeve fizike dhe mjedisore, për të siguruar që lagjet e varfëra dhe vendbanimet joformale të integrohen në dimensionet sociale, ekonomike, kulturore dhe politike të qyteteve. Këto strategji duhet të përfshijnë, sipas rastit, akses në strehim të qëndrueshëm, të përshtatshëm, të sigurtë dhe të përbalueshëm, në shërbime bazë dhe sociale; dhe hapësira publike të sigurta, përfshirëse, të arritshme, të gjelbërta, dhe cilësore; ato duhet të promovojnë sigurinë e pronësisë dhe rregullimin e saj, si dhe masat për parandalimin dhe ndërmjetësimin e konflikteve.

110. Ne do të mbështesin përpjekjet për të përcaktuar dhe për të përforcuar sistemet gjithëpërfshirëse dhe transparente të monitorimit për të ulur përqindjen e njerëzve që jetojnë në lagjet e varfra dhe vendbanimet joformale, duke pasur parasysh përvojat e fituara nga përpjekjet e mëparshme për të përmirësuar kushtet e jetesës së banorëve të lagjeve të varfra dhe të zonave informale.

111. Ne do të nxisim zhvillimin e rregulloreve të përshtatshme dhe të detyrueshme në sektorin e strehimit, duke përfshirë kodet e ndërtimeve, standardet, lejet e zhvillimit dhe rregulloret e planifikimit që u përgjigjen nevojave, luftimin dhe parandalimin e spekulimeve, të zhvendosjes, të qenit pa strehë, të dëbimeve të detyruara arbitrare, duke siguruar qëndrueshmëri, cilësi, përbalueshmëri, shëndet, siguri, akses, energji, efikasitet të burimeve, dhe elasticitet. Ne do të promovojmë gjithashtu dhe një analize të diferencuar të ofertës dhe kërkesës për strehim në bazë të cilësisë së lartë, në kohë, si dhe të dhëna të besueshme të ndara në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, duke pasur parasysh dimensionet e veçanta sociale, ekonomike, mjedisore dhe kulturore.

112. Ne do të promovojmë zbatimin e programeve të zhvillimit të qëndrueshëm urban duke vendosur në qendër të strategjisë strehimin dhe nevojat e njerëzve, me prioritet skemat e strehimit për të shmangur zhvillimet në masë, periferike dhe të izoluar të strehimit të shkëputura nga sistemet urbane, pavarësisht nga segmenti shoqëror dhe ekonomik në të cilin ato zhvillohen.

113. Ne do të marrim masa për të përmirësuar sigurinë rrugore dhe për ta integruar atë në planifikimin dhe projektimin e një lëvizje dhe infrastrukture të qëndrueshme transporti. Duke e shoqëruar me nisma ndërgjegjësimi, ne do të promovojmë qasjen e një sistemi të sigurt, të theksuar në Dekadën për Veprim të Kombeve të Bashkuara për sigurinë rrugore, duke i kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të të gjitha grave dhe vajzave, si dhe fëmijëve dhe të rinjëve, personave të moshuar dhe personave me aftësi të kufizuara dhe atyre që janë në nevojë. Ne do të miratojmë dhe zbatojmë politika dhe masa të tilla që, në mënyrë aktive, mbrojnë dhe promovojnë sigurinë e lëvizjes me këmbë dhe me bicikletë, me qëllim që të rriten përfitimet shëndetësore, veçanërisht parandalimi i lëndimeve dhe sëmundjeve jo të transmetueshme, dhe do të zhvillojmë dhe zbatojmë legjisllacion dhe politika gjithëpërfshirëse për sigurinë e motorçiklistëve, duke pasur parasysh numrin në rritje të vdekjeve dhe lëndimeve të motorçiklistëve në nivel global, veçanërisht në vendet në zhvillim. Ne do ta promovojmë udhëtimin e sigurt dhe të shëndetshëm në shkollë për çdo fëmije si prioritet në përputhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve.

114. Ne do të nxisim akses për të gjithë ndaj sistemeve të transportit urban, tokësor dhe detar të sigurt, përgjegjes ndaj moshës dhe gjinisë, të përgjegjshëm, të përballueshme, të arritshëm dhe të qëndrueshëm, duke bërë të mundur pjesëmarrjen kuptimplotë në aktivitetet sociale dhe ekonomike në qytete dhe vendbanime, duke integruar planet për transportin dhe lëvizjen në plane të përgjithshme urbane dhe territoriale dhe duke nxitur një gamë të gjerë të opsioneve të transportit dhe lëvizshmërisë, në veçanti duke mbështetur:

(a) rritjen e konsiderueshme të një infrastrukture të sigurt, të arritshme, efciente, të përballueshme, dhe të qëndrueshme të transportit publik, si dhe mundësi për transport jo të motorizuar, të tilla si ecja dhe pedalmi, duke i prioritetizuar ato mbi transportin e motorizuar privat;

(b) një zhvillim të barabartë të orientuar drejt tranzitit, i cili minimizon zhvendosjen, veçanërisht të të varfërve dhe përmban strehim të përballueshëm nga të ardhura mikse, dhe një miksim të vendeve të punës dhe shërbimeve;

(c) Një planifikim më të mirë dhe të koordinuar të përdorimit të transportit tokësor, duke çuar në një reduktim të nevojave për udhëtim dhe transport, duke përmirësuar lidhjen midis zonave urbane, periurbane dhe rurale, duke përfshirë planifikimin e rrugëve ujore, transportin dhe lëvizjen, sidomos për shtetet e vogla ishullore në zhvillim dhe qytetet bregdetare;

(d) Planifikimin urban të mallrave dhe koncepte logjistike që mundësojnë akses efcient në produkte dhe shërbime, duke minimizuar ndikimet në mjedis dhe jetesën në qytete dhe duke maksimizuar kontributin e tyre në rritjen ekonomike.

115. Ne do të marrim masat për të zhvilluar mekanizma dhe legjislacion të përbashkët në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor për të vlerësuar përfitimet e skemave urbane dhe metropolitane të transportit duke përfshirë ndikimet në mjedis, ekonomi, kohezionin social, cilësinë e jetës, aksesin, sigurinë rrugore, shëndetin publik, midis të tjerash, dhe aksionet ndaj ndryshimeve klimatike.

116. Ne do të mbështesim zhvillimin e këtyre mekanizmave dhe kornizave, bazuar në politika të qëndrueshme të transportit dhe lëvizjes urbane, për prokurim të qëndrueshëm, të hapur dhe transparent të shërbimeve dhe rregullim të transportit dhe shërbimeve të lëvizjes në zonat urbane dhe metropolitane, duke përfshirë teknologji të reja që mundësojnë shpërndarjen e shërbimeve të lëvizjeve, si dhe zhvillimin e marrëdhënieve të qarta, transparente dhe të përgjegjshme kontraktuale ndërmjet qeverive vendore dhe ofruesve të shërbimeve të transportit dhe lëvizjes, duke përfshirë menaxhimin e të dhënave, i cili garanton interesin publik, mbrojtjen e privatësisë individuale, dhe përcaktimin e detyrimeve reciproke.

117. Ne do të mbështesim një koordinim më të mirë ndërmjet departamenteve të planifikimit të transportit, planifikimit urban dhe territorial, një mirëkuptim të ndërsjellë të kornizave dhe politikave të planifikimit, në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor, nëpërmjet planeve të qëndrueshme urbane dhe metropolitane për transportin dhe lëvizshmërinë. Ne do të ofrojmë mbështetje për qeveritë rajonale dhe vendore për të zhvilluar njohuritë dhe kapacitetet e nevojshme për t'i zbatuar këto plane.



118. Ne do t'i mbështesim qeveritë rajonale dhe vendore për të zhvilluar dhe zgjeruar instrumentet e financimit, duke mundësuar përmirësimin e infrastrukturës dhe sistemeve të tyre të transportit dhe lëvizjes, të tilla si sistemet e tranzitimit masiv dhe të shpejtë me autobus, sistemet hekurudhore, korsitë e biçikletave, zonat e këmbësorëve, dhe inovacionet me bazë tek teknologjitë në sistemet e transportit dhe tranzitit për të reduktuar mbipopullimin dhe ndotjen ndërkohë që përmirësojmë efikasitetin, lidhjen, aksesin, sigurinë dhe cilësinë e jetës.

119. Ne do të promovojmë investime të përshtatshme, në infrastrukturë mbrojtëse, të arritshme dhe të qëndrueshme dhe në sistemet e ofrimit të shërbimeve të ujit, higjienë dhe kanalizime, drenazhime, menaxhimin e mbetjeve të ngurta, kullimet urbane, uljen e ndotjes së ajrit, si dhe menaxhimin e vërshimeve ujore, me synim që të përmirësojmë shëndetin dhe të sigurojmë akses universal dhe të barabartë për ujë të pijshëm, të sigurt dhe të përballueshëm për të gjithë; si dhe akses të përshtatshëm dhe të barabartë në kanalizime dhe higjienë për të gjithë; mbylljen e kanaleve të hapura të ujrave të zeza, me vëmendje të veçantë ndaj nevojave dhe sigurisë së grave dhe vajzave dhe personave në situata të cenueshme. Ne do të sigurojmë që kjo infrastrukturë të jetë fleksibël ndaj klimës dhe pjesë e planeve të integruara të zhvillimeve urbane dhe territoriale, duke përfshirë strehimin dhe lëvizshmërinë, ndër të tjera, dhe që të zbatohet në mënyrë pjesëmarrëse, duke pasur parasysh inovacionin, eficientësinë e burimeve, arritshmërinë, kontekstin specifik dhe zgjidhje të qëndrueshme dhe kulturalisht sensitive.

120. Ne do të punojmë për t'i pajisur ndërmarrjet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve me kapacitete për të zbatuar sisteme të qëndrueshme të menaxhimit të ujit, duke përfshirë mirëmbajtje të qëndrueshme të shërbimeve të infrastrukturës urbane, nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve, me synim eliminimin në mënyrë progresive të pabarazive, dhe duke promovuar si aksesin universal dhe të barabartë në ujin e pijshëm dhe të sigurt për të gjithë, ashtu dhe kanalizime dhe higjienë të përshtatshme për të gjithë.

121. Ne do të sigurojmë akses universal në shërbime energjitike të përballueshme, të qëndrueshme dhe moderne duke promovuar energjinë efiçente dhe energjinë e rinovueshme të qëndrueshme, dhe duke i mbështetur qeveritë rajonale dhe vendore për t'i aplikuar ato në ndërtesa publike, infrastrukturë dhe objekte, si dhe duke përfituar nga kontrolli i tyre i drejtpërdrejtë, kur është i zbatueshëm, mbi infrastrukturën dhe kodet lokale, për të nxitur më shumë përdorimin efiçent të energjisë në sektorët e përdoruesve fundorë, të tillë si rezidenca për banim, për përdorim tregtar dhe industrial, industrinë, transportin, mbetjet dhe kanalizimet. Ne gjithashtu inkurajojmë miratimin e kodeve dhe standardeve të ndërtimit, objektivave të portofolit të rinovueshëm, etiketimin e efiçencës së energjisë, rivitalizimin e ndërtesave ekzistuese dhe politikat e prokurimit publik për energjinë, krahas modaliteteve të tjera, sipas rastit, për të arritur objektivat e efiçencës së energjisë. Ne do t'u japin përparësi rrjeteve inteligjente, sistemeve energjetike të qarkut dhe planeve të energjisë në komunitet për të përmirësuar sinergjinë ndërmjet energjisë së rinovueshme dhe efiçencës së energjisë.

122. Ne do të mbështesim vendimmarrjen e decentralizuar në depozitimin e mbetjeve për të promovuar akses universal në sistemet e menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve. Ne do të

mbështesim promovimin e skemave të zgjeruara përgjegjëse për prodhuesit e mbetjeve, duke përfshirë gjeneruesit dhe prodhuesit e mbetjeve në financimin e sistemeve të menaxhimit të mbetjeve urbane dhe duke reduktuar rreziqet dhe ndikimet social ekonomike të mbetjeve dhe duke rritur shkallën e riciklimit përmes projektimit më të mirë të produktit.

123. Ne do të inkurajojmë integrimin e nevojave ushqimore për banorët e zonave urbane, veçanërisht në zonat e varfëra urbane dhe territoriale, për t'i dhënë fund urisë dhe kequshqyerjes. Ne do të promovojmë koordinimin e politikave të sigurisë ushqimore në zonat urbane, peri-urbane dhe rurale për të lehtësuar prodhimin, magazinimin, transportin dhe tregtimin e ushqimit tek konsumatorët në mënyrë të përshtatshme dhe të përballueshme për të reduktuar humbjet e ushqimit dhe për të parandaluar ripërdorimin e mbetjeve nga ushqimi. Ne do të nxisim koordinimin e politikave të ushqimit me politikatat e energjisë, ujit, transportit, mbetjeve, dhe politikatat e tjera në zonat urbane për të maksimizuar efikasitetin dhe për të minimizuar mbetjet.

124. Ne do ta përfshijmë kulturën si një komponent prioritar të planeve dhe strategjive urbane gjatë miratimit të instrumenteve të planifikimit, duke përfshirë masterplanet, udhëzimet e zonimit, kodet e ndërtimit, politikatat e menaxhimit të bregdetit, dhe politikatat strategjike të zhvillimit që ruajnë një gamë të larmishme të trashëgimisë kulturore, materiale dhe jo materiale, dhe të peisazheve, dhe do t'i mbrojmë ato nga ndikimet e mundshme shkatërruese të zhvillimit urban.

125. Ne do të mbështesim sigurimin e trashëgimisë kulturore për zhvillimin e qëndrueshëm urban, do ta njohim rolin e saj në nxitjen e pjesëmarrjes dhe përgjegjësisë, dhe do të nxitim përdorimin inovativ dhe të qëndrueshëm të monumenteve arkitektonike me qëllim krijimin e vlerës, nëpërmjet restaurimit të respektueshëm dhe të përshtatshëm. Ne do të angazhojmë popujt indigjene dhe komunitetet lokale në promovimin dhe përhapjen e njohurive të trashëgimisë kulturore, materiale dhe jomateriale, dhe në mbrojtjen e shprehjeve tradicionale dhe gjuhës, nëpërmjet përdorimit të teknologjive dhe teknikave të reja.

Mjetet e zbatimit

126. Ne e dimë se zbatimi i Axbendës së Re Urbane kërkon një mjedis të përshtatshëm dhe një gamë të gjerë të mjeteve të zbatimit, duke përfshirë qasjen në shkencë, teknologji, dhe inovacion dhe zgjerimin e njohurive duke bashkëndarë, bazuar në reciprocitet, zhvillimin e kapaciteteve dhe mobilizimin e burimeve financiare, duke u përfshirë në të gjitha burimet e vlefshme tradicionale dhe inovative në nivel global, rajonal, kombëtar, rajonal dhe lokal, si dhe zgjerimin e bashkëpunimit dhe partneriteteve ndërkombëtare ndërmjet të gjitha niveleve të qeverisjeve, sektorit privat, shoqërisë civile dhe sistemit të Kombeve të Bashkuara, dhe aktorëve të tjerë, bazuar në parimet e barazisë, mosdiskriminimit, llogaridhënies, respektimit të të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtën për zhvillim, dhe solidaritetit, sidomos për ata që janë më të varfër dhe më në nevojë.

127. Ne i riafirmojmë angazhimet lidhur me mjetet e zbatimit të përfshira në Axbendën për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030 dhe Axbendën për Veprim për Financimin e Zhvillimit, të miratuar në Adis Abeba.



128. Ne do ta inkurajojmë UN-Habitat-in, programe dhe agjenci të tjera të Kombeve të Bashkuara dhe aktorë të tjerë për të gjeneruar udhëzime praktike dhe të bazuara në të dhëna për zbatimin e Axtendës së Re Urbane dhe dimensionin urban të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, në bashkëpunim të ngushtë me shtetet anëtare, autoritetet vendore, grupet kryesore dhe aktorë të tjerë përkatës, si dhe përmes mobilizimit të ekspertëve. Ne mbështetem tek trashëgimia e Konferencës së Habitat III dhe mësimet e nxjerra nga procesi përgatitor i saj, duke përfshirë dhe takimet rajonale dhe tematike. Në këtë kuadër ne theksojmë, ndër të tjera, kontributet e vjera të Fushatës Botërore Urbane, Asamblesë së Përgjithshme të Partnerëve për Habitat III dhe Rrjetit Global të Instrumenteve të Tokës.

129. Ne i bëjmë thirrje UN-Habitat-it të vazhdojë punën për të zhvilluar njohuritë normative dhe për të ofruar mbështetje për zhvillimin e kapaciteteve dhe mjeteve për qeveritë kombëtare dhe vendore për projektimin, planifikimin dhe menaxhimin e zhvillimit të qëndrueshëm urban.

130. Ne e pranojmë që zhvillimi i qëndrueshëm urban, i udhëhequr nga politika dhe strategji urbane, sipas nevojës, mund të përfitojë nga rrjetet e integruara të financimit të cilat mbështeten nga një mjedis mundësues në të gjitha nivelet. Ne e pranojmë rëndësinë e të siguruarit që të gjitha mjetet financiare të zbatimit të jenë të mishëruara në korniza politikash koherente dhe procese decentralizimi fiskal, sipas rastit, si dhe njëhim rëndësinë e ndërtimit të kapaciteteve të përshatshme në të gjitha nivelet.

131. Ne i mbështesim qasjet që kanë të bëjnë me financimin e urbanizimit dhe ngritjen e kapaciteteve të menaxhimit financiar në të gjitha nivelet e qeverisjes, miratimin e instrumenteve të veçanta dhe mekanizmave të nevojshme për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm urban, duke pranuar se çdo vend ka përgjegjësinë e vet kryesore për zhvillimin ekonomik dhe social të tij.

132. Ne do t'i mobilizojmë burimet endogjene dhe të ardhurat e mbledhura nëpërmjet thithjes së përfitimeve të urbanizimit, si dhe efektet e përshpejtitimit dhe maksimizimit të ndikimit të investimeve publike dhe private me qëllim përmirësimin e kushteve financiare për zhvillimin urban dhe mundësimin e aksesit ndaj burimeve të tjera duke ditur se, për të gjitha shtetet, politikat publike, mobilizimi dhe përdorimi efektiv i burimeve vendase, nënvizuar nga parimi i përkatësisë kombëtare, përbën fokusin e veprimeve tona të përbashkëta për zhvillimin e qëndrueshëm urban, duke përfshirë zbatimin e Axtendës së Re Urbane.

133. Ne i bëjmë thirrje biznesit të vërë në zbatim kreativitetin dhe inovacionin e vet drejt zgjidhjeve të sfidave të zhvillimit të qëndrueshëm në zonat urbane, duke pranuar se aktiviteti i biznesit privat, investimet dhe inovacioni janë shtytësit kryesorë të produktivitetit, rritjes përfshirëse dhe hapjes së vendeve të punës dhe se investimet private, veçanërisht investimet e huaja direkte, së bashku me një sistem ndërkombëtar financiar të qëndrueshëm, janë plotësues jetikë të përpjekjeve për zhvillim.

134. Ne do të mbështesim politikat dhe kapacitetet e duhura që u mundësojnë qeverive rajonale dhe vendore të regjistrojnë dhe të zgjerojnë bazën e të ardhurave të tyre potenciale, si, për shembull,

perms sistemit kadastral shumëqëllimshëm, taksave lokale, tarifave dhe pagesave të shërbimeve shumëqëllimshme, në përputhje me politikat kombëtare, duke siguruar në të njëjtën kohë që gratë dhe vajzat, fëmijët dhe të rinjtë, personat e moshuar, personat me aftësi të kufizuara, popujt indigenë dhe komunitetet lokale, si dhe familjet e varfra, nuk preken në mënyrë jo përpjestimore.

135. Ne do të inkurajojmë sisteme të shëndosha dhe transparente të transfertave financiare nga qeveria kombëtare për qeveritë rajonale dhe vendore, bazuar në nevojat, prioritetet, funksionet, mandatet e tyre, dhe në stimuj bazuar në performancë, sipas rastiit, duke iu ofruar atyre burime të përshtatshme, në kohë, dhe të parashikueshme dhe duke nxitur aftësitë e tyre për të rritur të ardhurat dhe për të menaxhuar shpenzimet.

136. Ne do të mbështesim zhvillimin e modeleve vertikale dhe horizontale të shpërndarjes së burimeve financiare për të reduktuar pabarazitë ndërmjet territoreve, në qendrat urbane, si dhe ndërmjet zonave urbane dhe rurale, si dhe për të promovuar zhvillimin e integruar dhe të balancuar territorial. Në këtë drejtim, ne theksojmë rëndësinë e përmirësimit të transparencës së të dhënave për shpenzimet dhe shpërndarjen e burimeve si mjet për të vlerësuar progresin drejt barazisë dhe integritimit hapësinor.

137. Ne do të inkurajojmë praktikat më të mira që mundësojnë marrjen dhe shpërndarjen e vlerës sa rritur të tokës dhe pronës, krijuar si rezultat i proceseve të zhvillimeve urbane, projekteve infrastrukturore dhe investimeve publike. Mund të merren masa, të tilla si politika fiskale që lidhen me fitimin, sipas rastiit, për të parandaluar kapjen private, si dhe spekulimet ndaj tokës dhe pasurive të paluajtshme. Ne do të përforcojmë lidhjen midis sistemeve fiskale, planifikimit urban, si dhe mjeteve të menaxhimit urban, duke përfshirë rregullat e tregut të tokës. Ne do të punojmë për t'u siguruar që përpjekjet për të gjeneruar ta ardhura financiare bazuar tek toka nuk çojnë në përdorim dhe konsum të paqëndrueshëm të tokës.

138. Ne do t'i mbështesim qeveritë rajonale dhe lokale për të zbatuar instrumente transparente dhe të përgjegjshme për kontrollin e shpenzimeve, bazuar në kontrollin ligjor dhe pjesëmarrjen publike, sipas rastiit, në mbështetje të proceseve të tenderimit dhe mekanizmave të prokurimit të hapura dhe të ndershme, ekzekutimin e besueshëm të buxhetit, si dhe masat parandaluese antikorruption për të promovuar menaxhimin e integruar, të përgjegjshëm dhe efektiv, dhe aksesin në pronën dhe tokën publike, në përputhje me politikat kombëtare.

139. Ne do të mbështesim krijimin e kornizave të plota ligjore dhe rregullatore për huamarrje të qëndrueshme kombëtare dhe bashkiake, bazuar në menaxhimin e qëndrueshëm të borxhit, të mbështetur nga të ardhura dhe kapacitete të përshtatshme, nëpërmjet kreditorëve lokalë, si dhe tregjeve të qëndrueshme dhe të zgjeruara bashkiake të borxhit, kur është e mundur. Ne do të shqyrtojmë mundësinë e krijimit të ndërmjetësueve të përshtatshëm financiarë për financimet urbane, të tilla si, fondet e zhvillimit ose financimet nga bankat e zhvillimit, ndër-rajonale, kombëtare, rajonale dhe vendore, duke përfshirë edhe mekanizmat e përbashkëta të financimit, të cilat mund të përshpejtojnë financimet publike dhe private, kombëtare dhe ndërkombëtare. Ne do të punojmë për të mbështetur mekanizmat e mënjanimiit të riskut siç janë Agjencia e Garancisë së Investimeve

Shumëpalëshe, ndërkohë që menaxhojmë riskun monetar, për të ulur koston e kapitalit dhe për të stimuluar sektorin privat dhe familjet për të marrë pjesë në zhvillimin e qëndrueshëm urban dhe përpjekjet për ndërtimin e fleksibilitetit, duke përfshirë aksesin në mekanizmat e transferimit të rrezikut.

140. Ne do të mbështesim zhvillimin e produkteve financiare të strehimit të përshtatshëm dhe të përballeshëm; dhe do të inkurajojmë pjesëmarrjen e një game të larmishme institucionesh multilaterale financiare, bankave të zhvillimit rajonal dhe institucioneve financiare të zhvillimit; agjencive të bashkëpunimit; huadhënësve të sektorit privat dhe investitorët, bashkëpunëtorëve, huadhënësve të parave dhe bankave mikrofinanciare, për të investuar për strehim të përballeshëm dhe në rritje në të gjitha format e tij.

141. Ne do të shqyrtojmë po ashtu mundësinë e krijimit të një infrastrukture të transportit urban dhe territorial dhe të fondeve të shërbimeve në nivel kombëtar, bazuar në një shumëllojshmëri të burimeve të financimit, duke filluar nga grantet publike deri tek kontributet nga subjekte të tjera publike dhe sektori privat, duke siguruar koordinimin dhe ndërhyrjet midis aktorëve si dhe llogaridhënien.

142. Ne i ftojmë institucionet financiare ndërkombëtare shumëpalëshe, bankat e zhvillimit rajonal, institucionet financiare të zhvillimit, si dhe agjencitë e bashkëpunimit të sigurojnë mbështetje financiare, nëpërmjet mekanizmave të reja financiare, për programet dhe projektet për zbatimin e Axtendës së Re Urbane, veçanërisht në vendet në zhvillim.

143. Ne mbështesim aksesin në fondet e ndryshme shumëpalëshe, duke përfshirë Fondin e Klimës së Gjelbër, Fondin e Mjedisit të Gjelbër, Fondin e Përshtatjes së Gjelbër, Fondin e Investimeve të Klimës, për të siguruar burime për planet, politikat, programet dhe veprimet për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe zbutjen e ndryshimeve klimaterike, për qeveritë rajonale dhe vendore. Ne do të bashkëpunojmë me institucionet financiare rajonale dhe vendore, sipas rastit, për të zhvilluar zgjidhje infrastrukturore për financimet klimatike dhe për të krijuar mekanizmat e duhura për të identifikuar instrumente katalitike financiarë, në përputhje me cdo kornizë ligjorekombëtare për të siguruar qëndrueshmërinë fiskale dhe të borxhit në të gjitha nivelet e qeverisjes.

144. Ne do të shqyrtojmë dhe zhvillojmë zgjidhje të mundshme për rreziqet klimatike dhe fatkeqësitë në qytete dhe vendbanime, nëpërmjet bashkëpunimit me institucionet e sigurimit dhe risigurimit dhe aktorët e tjerë përkatës, në lidhje me investimet në infrastrukturën urbane dhe metropolitane, ndërtesat, dhe pasuritë e tjera urbane, si dhe për popullsitë lokale për t'u siguruar atyre strehim dhe plotësim të nevojave ekonomike.

145. Ne mbështesim përdorimin e financave ndërkombëtare publike, duke përfshirë asistencën zyrtare për zhvillim, midis të tjerash, për të nxitur mobilizimin e burimeve shtesë nga të gjitha burimet në dispozicion, publike dhe private, për një zhvillim të qëndrueshëm urban dhe territorial. Kjo mund të përfshijë zbutjen e rreziqeve për investitorët potencialë, duke pranuar faktin që financat ndërkombëtare publike luajnë rol të rëndësishëm në plotësimin e përpjekjeve të vendeve për të

mobilizuar burimet e brendshme publike, sidomos në vendet më të varfëra dhe më të rrezikuara, që kanë burime të brendshme të kufizuara.

146. Ne do të zgjerojmë mundësitë për bashkëpunimin Veri-Jug, Jug-Jug, trekëndëshin rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe për bashkëpunimin rajonal të decentralizuar qytet-me-qytet, sipas rastit, për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm urban, zhvillimin e kapaciteteve dhe për të nxitur shkëmbimet për zgjidhjet urbanistike dhe mësimet e ndërsjella në të gjitha nivelet dhe ndërmjet të gjithë aktorëve.

147. Ne do të promovojmë zhvillimin e kapaciteteve si një qasje me shumë aspekte që trajton aftësinë e aktorëve të shumtë dhe të institucioneve në të gjitha nivelet e qeverisjes, dhe kombinon kapacitetet individuale, shoqërore, dhe institucionale për të formuluar, zbatuar, rritur, menaxhuar, monitoruar dhe vlerësuar politikatat publike për zhvillim të qëndrueshëm urban.

148. Ne do të promovojmë forcimin e kapaciteteve të qeverive kombëtare, rajonale dhe lokale, duke përfshirë shoqatat e qeverisjes vendore, sipas rastit, për të punuar me gratë dhe vajzat, fëmijët dhe të rinjtë, personat e moshuar dhe personat me aftësi të kufizuara, popujt indigjenë dhe komunitetet lokale, dhe ata që janë në situata të rrezikuara si dhe me shoqërinë civile, akademike dhe institucionet kërkimore në formësimin e proceseve të qeverisjes organizative dhe institucionale, duke u lejuar atyre të marrin pjesë në mënyrë efektive në vendimmarrjen për zhvillimin urban dhe territorial.

149. Ne do të mbështesim shoqatat e qeverisjes lokale, si promovuese dhe ofruese të zhvillimit të kapaciteteve, duke njohur dhe forcuar, sipas rastit, si përfshirjen e tyre në konsultimet kombëtare për politikatat urbane dhe prioritetet e zhvillimit, ashtu dhe bashkëpunimin e tyre me qeveritë rajonale dhe vendore, së bashku me shoqërinë civile, sektorin privat, profesionistët, institucionet akademike dhe kërkimore dhe rrjetet ekzistuese të tyre, për të shpërndarë programet e zhvillimit të kapaciteteve. Kjo duhet bërë nëpërmjet mësimit-përmes-monitorimit, partneriteteve që lidhen me objektin, dhe aksioneve bashkëpunuese të tilla si bashkëpunimi ndër-bashkiak, në nivel global, ndër-rajonal, kombëtar, rajonal dhe vendor, duke përfshirë krijimin e rrjeteve të praktikuesve dhe praktikave ballafaquese të politikave shkencore.

150. Ne nënvizojmë nevojën për rritje të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të njohurive mbi shkencën, teknologjinë dhe novacionin në përfitim të zhvillimit të qëndrueshëm urban, në koherencë, koordinim dhe sinerji të plotë me proceset e Mekanizmit të Lehtësimit të Teknologjisë, të krijuar bazuar në Axtendën e Masave të Addis Ababa-s dhe të prezantuar nën Axtendën për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2030.

151. Ne do të promovojmë programet e zhvillimit të kapaciteteve për të ndihmuar qeveritë rajonale dhe lokale në planifikimin dhe menaxhimin financiar, të bazuar në koordinimin institucional në të gjitha nivelet, duke përfshirë ndjeshmërinë mjedisore dhe masat antikorrupsion, duke nxitur mbikëqyrjen transparente dhe të pavarur, prokurimin financiar, procesin e raportimit, auditimit dhe monitorimit, dhe duke rishikuar performancën dhe përputhshmërinë ndër-rajonale dhe kombëtare,

me vëmendje të veçantë ndaj buxhetimit të ndjeshëm ndaj moshës dhe gjinisë dhe përmirësimit dhe dixhitalizimit të proceseve të kontabilitetit dhe të dhënave, për të promovuar qasje të bazuara në rezultate, dhe për të ndërtuar kapacitete administrative dhe teknike afatmesme deri në afatgjatë.

152. Ne do të promovojmë programet e zhvillimit të kapaciteteve mbi përdorimin e të ardhurave dhe mjeteve të financimit nga përdorimi i ligjshëm i tokës, si dhe për funksionimin e tregut të pasurive të paluajtshme për politikëbërësit dhe zyrtarët publikë lokalë duke u përqendruar tek bazat ligjore dhe ekonomike të kapjes së vlerës, duke përfshirë kuantifikimin, kapjen, dhe shpërndarjen e rritjes së vlerës së tokës.

153. Ne do të promovojmë përdorimin sistematik të partneritetit shumëpalësh në proceset e zhvillimit urban, sipas rastit, krijimin e politikave, kornizave dhe procedurave financiare dhe administrative të qarta dhe transparente, si dhe udhëzimeve për planifikimin e partneriteteve shumëpalëshe (me pjesëmarrjen e shumë aktorëve).

154. Ne e pranojmë kontributin e rëndësishëm të iniciativave vullnetare të bashkëpunimit, partneriteteve dhe koalicioneve që planifikojnë të nxisin dhe të zgjerojnë zbatimin e Axtendës së Re Urbane, duke nënvizuar praktikat më të mira dhe zgjidhjet novatore, duke përfshirë promovimin e rrjeteve të bashkëprodhimit ndërmjet subjekteve rajonale, qeverive vendore dhe aktorëve të tjerë përkatës.

155. Ne do të promovojmë iniciativat për zhvillimin e kapaciteteve për të fuqizuar dhe për të forcuar aftësitë dhe mundësitë e grave dhe vajzave, fëmijëve dhe të rinjve, personave të moshuar dhe personave me aftësi të kufizuara, popujve indigjenë dhe komuniteteve lokale, si dhe personave në situata vulnerabël, për të formësuar proceset qeverisëse, duke u angazhuar në dialog, dhe duke promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut dhe antidiskriminimin, për të siguruar pjesëmarrjen e tyre në mënyrë efektive në vendimmarrjen për zhvillimin urban dhe territorial.

156. Ne do të nxisim zhvillimin e politikave kombëtare të informimit dhe teknologjisë së komunikimit dhe strategjive të qeverisjes dixhitale, si dhe mjeteve dixhitale qeverisëse të përqendruar tek qytetarët, si dhe risitë teknologjike, duke përfshirë programet e zhvillimit të kapaciteteve, në mënyrë që teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit të bëhen të aksesueshme për publikun, duke përfshirë gratë dhe vajzat, fëmijët dhe të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara, personat e moshuar dhe personat në situata në nevojë, për t'u mundësuar atyre që të zhvillojnë dhe të ushtrojnë përgjegjësinë qytetare, zgjerimin e pjesëmarrjes dhe nxitjen e qeverisjes së përgjegjshme, si dhe rritjen e efikasitetit. Përdorimi i platformave dhe mjeteve dixhitale, duke përfshirë sistemet e informacionit gjeohapësinor, do të inkurajohen për të përmirësuar planifikimin afatgjatë të integruar urban dhe territorial, si dhe qasjen në shërbimet urbane dhe metropolitane.

157. Ne do të mbështesim shkencën, kërkimin, dhe inovacionin, duke u përqendruar edhe tek risitë sociale, teknologjike, dixhitale dhe të bazuara në natyrë, ballafaqimet e shëndosha shkencore-politike lidhur me planifikimin urban dhe territorial dhe formulimin e politikave, si dhe mekanizmat institucionalë për ndarjen dhe shkëmbimin e informacionit, njohurive dhe ekspertizës, duke

përfshirë mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e të dhënave me bazë gjeografike, të mbledhura në komunitet, me cilësi të lartë, në kohë dhe të besueshme, të ndara sipas të ardhurave, gjinisë, moshës, racës, etnisë, aftësisë së kufizuar, vendndodhjes gjeografike, dhe karakteristikave të tjera përkatëse në kontekste kombëtare, rajonale dhe vendore.

158. Ne do të forcojmë të dhënat dhe kapacitetet statistikore në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor për të monitoruar në mënyrë efektive progresin e arritur në zbatimin e politikave dhe strategjive të zhvillimit të qëndrueshëm urban, dhe për të informuar vendimmarrjen dhe komentet e duhura. Procedurat e mbledhjes së të dhënave për implementimin e detyrave dhe rishikimit të Axtendës së Re Urbane duhen kryesisht të bazohen në burimet zyrtare kombëtare, rajonale dhe lokale të të dhënave, dhe në burime të tjera, kur shihet e nevojshme, si dhe duhet të jenë të hapura, transparente dhe në përputhje me qëllimin e respektimit të të drejtave të privatësisë dhe të gjitha detyrimet dhe angazhimet e të drejtave të njeriut. Kjo punë mund të mbështetet nga progresi drejt një përkufizimi global të bazuar tek njerëzit e qyteteve dhe vendbanimeve.

159. Ne do të mbështesim rolin dhe kapacitetin e zgjeruar të qeverive rajonale dhe vendore në mbledhjen e të dhënave, hartëzimin, analizën dhe shpërndarjen, si dhe promovimin e qeverisjes së bazuar në të dhëna, duke u mbështetur në një bazë të përbashkët njohurish, duke përdorur si të dhënat globalisht të krahasueshme ashtu edhe ato të gjeneruara në nivel vendor, duke përfshirë regjistrimet, anketat e familjeve, regjistrat e popullsisë, proceset e monitorimit me bazë komunitare dhe burime të tjera përkatëse, të ndara sipas të ardhurave, gjinisë, moshës, racës, etnisë, aftësisë së kufizuar, vendndodhjes gjeografike, dhe karakteristikave të tjera të rëndësishme në kontekstet kombëtare, rajonale, dhe lokale.

160. Ne do të nxisim krijimin, promovimin dhe shtimin e platformave pjesëmarrëse të të dhënave të hapura për të gjithë duke përdorur mjetet teknologjike dhe sociale në dispozicion për të transferuar dhe për të ndarë njohuritë midis qeverive kombëtare, rajonale dhe vendore dhe palëve të interesuara, duke përfshirë aktorë dhe individë joshitetërorë, për të përmirësuar planifikimin dhe menaxhimin efektiv urban, efikasitetin dhe transparencën përmes e-qeverisjes, teknologjive të informacionit dhe komunikimit, dhe për të përmirësuar menaxhimin e informacionit gjeohapësinor.

Ndjekja dhe rishikimi

161. Ne do ta ndjekim dhe rishikojmë periodikisht Axtendën e Re Urbane, duke siguruar koherencë në nivele kombëtare, rajonale dhe globale, me qëllim që të monitorojmë përparimin, të vlerësojmë ndikimin dhe sigurojmë zbatimin efektiv dhe në kohë, llogaridhënie ndaj qytetarëve tanë dhe transparencë në mënyrë përfshirëse.

162. Ne inkurajojmë ndjekjen dhe rishikimin vullnetar të Axtendës së Re Urbane, përmes një procesi të hapur, gjithëpërfshirës, shumënivelësh, pjesëmarrës dhe transparent, të drejtuar nga vetë shtetet. Procesi duhet të marrë parasysh kontributet e qeverive në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor, të cilat duhen plotësuar nga kontributet nga sistemi i Kombeve të Bashkuara, organizatat



rajonale dhe nënrajonale, grupet e mëdha dhe aktorët përkatës dhe duhet të jetë një proces i vazhdueshëm me qëllim krijimin dhe forcimin e partneriteteve midis të gjitha palëve të interesuara dhe nxitjen e shkëmbimit të zgjidhjeve urbanistike dhe të mësuarit reciprok.

163. Ne e pranojmë rëndësinë e qeverive vendore si partnerë aktivë për ndjekjen dhe rishikimin e Axtendës së Re Urbane në të gjitha nivelet, dhe i inkurajojmë ato për të zhvilluar, së bashku me qeveritë kombëtare dhe rajonale, sipas nevojës, mekanizmat e zbatimit, ndjekjes dhe rishikimit në nivel vendor, nëpërmjet shoqatave dhe platformave të tjera të përshtatshme. Ne do të marrim parasysh fuqizimin, kur është e nevojshme, të kapaciteteve të tyre për të kontribuar në këtë drejtim.

164. Ne theksojmë se ndjekja dhe rishikimi i Axtendës së Re Urbane duhet të ketë lidhje efektive me ndjekjen dhe rishikimin e Axtendës për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030 për të siguruar koordinimin dhe koherencën në zbatimin e tyre.

165. Ne riafirmojmë rolin dhe ekspertizën e UN-Habitat-it, brenda mandatit të tij, si pikë fokale për urbanizimin dhe vendbanimet e qëndrueshme, në bashkëpunim me subjektet e tjera të sistemit të Kombeve të Bashkuara, të ndërgjegjshëm për lidhjet që ekzistojnë midis urbanizimit të qëndrueshëm dhe, inter alia, zhvillimit të qëndrueshëm, reduktimit të rreziqeve nga fatkeqësitë dhe ndryshimet klimatike.

166. Ne e ftojmë Asamblenë e Përgjithshme t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm, me kontribute vullnetare nga shtetet dhe organizatat rajonale dhe ndërkombëtare, të raportojë mbi ecurinë e zbatimit të Axtendës së Re Urbane çdo katër vjet, dhe raporti i parë të paraqitet gjatë sesionit të 72-të të Asamblesë.

167. Ky raport do të ofrojë një analizë cilësore dhe sasore të progresit të bërë në zbatimin e Axtendës së Re Urbane dhe të qëllimeve dhe objektivave përkatëse, të pranuar ndërkombëtarisht, të urbanizimit dhe vendbanimeve të qëndrueshme. Kjo analizë do të bazohet në aktivitetet e qeverive kombëtare, rajonale dhe vendore, UN-Habitat-it, enteve të tjera përkatëse të sistemit të Kombeve të Bashkuara, aktorëve përkatës, në mbështetje të zbatimit të Axtendës së Re Urbane dhe raportimeve të Këshillit Drejtues të UN-Habitat. Ky raport duhet të përfshijë, sa më shumë që të jetë e mundur, kontributet e dala nga proceset dhe organizatat shumëpalëshe, kur është e përshtatshme, të shoqërisë civile, sektorit privat dhe sektorëve akademikë. Ai duhet të ndërtohet mbi platforma dhe procese ekzistuese, të tilla si Forumi Botëror Urban i thirrur nga UN-Habitat-i. Raporti duhet të përfshijë, në masën më të madhe të mundshme, kontribute dhe procese nga organizatat ndërkombëtare multilaterale dhe, aty ku mundet, nga shoqëritë civile, sektori privat dhe institucionet akademike. Ai duhet të mbështetet në platformat dhe proceset ekzistuese sic janë Forumi Botëror Urban i thirrur nga UN-Habitat. Raporti duhet të shmangë mbivendosjet, t'u përgjigjet rrethanave, legjisllacionit, kapaciteteve, nevojave, dhe prioriteteve vendore, rajonale dhe kombëtare.

168. Përgatitja e këtij raporti do të koordinohet nga UN-Habitat-i, në bashkëpunim të ngushtë me subjektet e tjera përkatëse të sistemit të Kombeve të Bashkuara, duke siguruar një proces

të koordinuar gjithëpërfshirës në tërë sistemin e OKB-së. Ky raport do t'i paraqitet Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet Këshillit Ekonomik dhe Social¹⁸. Raporti do të shërbejë për informim dhe për Forumin Politik të Nivelit të Lartë mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm, nën kujdesin e Asamblesë së Përgjithshme, me synim sigurimin e koherencës, koordinimit dhe lidhjeve bashkëpunuese që kanë të bëjnë me ndjekjen dhe rishikimin e Axtendës së Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030.

169. Ne do të vazhdojmë të forcojmë përpjekjet mobilizuese përmes partneriteteve, mbështetjeve dhe aktiviteteve ndërgjegjësuese për zbatimin e Axtendës së Re Urbane duke përdorur iniciativat ekzistuese, të tilla si: Dita Botërore e Habitatit dhe Dita Botërore e Qyteteve, si dhe duke pasur parasysh krijimin e iniciativave të reja për të mobilizuar dhe gjeneruar mbështetje nga shoqëria civile, qytetarët dhe grupet e interesit. Ne jemi të ndërgjegjshëm për rëndësinë që merr vazhdueshmëria e angazhimit për ndjekjen dhe rishikimin e Axtendës së Re Urbane me shoqatat e qeverive rajonale dhe vendore, përfaqësuar në Asamblenë Botërore të Qeverive Lokale dhe Rajonale.

170. Ne riafirmojmë Rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme 51/177 të 16 Dhjetorit 1996, 56/206 të 21 dhjetorit 2001, 67/216, 68/239 dhe 69/226, si dhe rezolutat e tjera përkatëse të Asamblesë, duke përfshirë rezolutat 31/109 të 16 Dhjetorit 1976 dhe 32/162 të 19 dhjetorit 1977. Ne e theksojmë rëndësinë e vendndodhjes së selisë së UN-Habitat-it në Nairobi.

171. Ne e theksojmë rëndësinë që UN-Habitat-i i jep rolit të sistemit të Kombeve të Bashkuara si pikë fokale për urbanizimin dhe vendbanimet e qëndrueshme, duke përfshirë zbatimin, ndjekjen dhe rishikimin e Axtendës së Re Urbane, në bashkëpunim me entitete të tjera të sistemit të Kombeve të Bashkuara.

172. Në dritën e Axtendës së Re Urbane dhe me synimin për të rritur efektivitetin e UN-Habitat-it, i kërkojmë Sekretarit të Përgjithshëm që t'i dorëzojë Asamblesë së Përgjithshme gjatë seancës së 71-të të saj një vlerësim të bazuar në të dhëna dhe të pavarur të UN-Habitat-it. Rezultati i vlerësimit do të jetë një raport që përmban rekomandime për të rritur efektivitetin, llogaridhënien dhe mbikëqyrjen e UN-Habitat-it dhe në këtë aspekt duhet të analizojë:

(a) Mandatin normativ dhe operacional të UN-Habitat-it;

(b) Strukturën qeverisëse të UN-Habitat-it për vendimmarrje më efektive, llogaridhënese dhe transparente, duke shqyrtuar alternativat, duke përfshirë universalizimin e anëtarësimit të Këshillit të saj Qeverisëse;

(c) Punën e UN-Habitat-it me qeveritë kombëtare, rajonale dhe vendore dhe me aktorë të tjerë me qëllim përfitimin e potencialit të plotë nga partneritetet;

(d) Kapacitetin financiar të UN-Habitat-it.

¹⁸ Raporti synon të zëvendësojë raportin e Sekretarit të Përgjithshëm për Këshillin e Ekonomik dhe Social mb implementimin e koordinuar të Axtendës Habitat. Ai synon gjithashtu të jetë pjesë, dhe jo shtojcë, e raportit të Sekretarit të Përgjithshëm kërkuar nga Asambleja e Përgjithshme në rezolutën e saj sipas pikës përkatëse të axhendës.



173. Ne vendosim të organizojmë një Takim Dyditor të Nivelit të Lartë të Asamblesë së Përgjithshme, i cili do të thirret nga Presidenti i Asamblesë së Përgjithshme, për të diskutuar zbatimin efektiv të Axbendës së Re Urbane dhe pozicionimin e UN-Habitat-it në këtë drejtim. Në takim do të diskutohen, ndër të tjera, praktikat më të mira, historitë e suksesit, dhe masat e përfshira në këtë raport. Përmbledhja e kryesuesit të takimit do të shërbejë si kontribut për Komitetin e Dytë lidhur me shqyrtimin e masave që do të merren në kuadër të rekomandimeve të vlerësimit të pavarur, në rezolutën vjetore, bazuar në pikën përkatëse të axhendës.

174. Ne e inkurajojmë Asamblenë e Përgjithshme të marrë në konsideratë thirrjen e Konferencës së katërt të Kombeve të Bashkuara mbi Strehimin dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban (Habitat IV) në vitin 2036 për të rinovuar angazhimin politik për të vlerësuar dhe për të konsoliduar progresin e Axbendës së Re Urbane.

175. Ne i kërkojmë Sekretarit të Përgjithshëm që, në raportin katërvjeçar, i cili do të paraqitet në vitin 2026, në përputhje me paragrafin 166 më sipër, të analizojë progresin e arritur dhe sfidat e hasura në zbatimin e Axbendës së Re Urbane që prej miratimit të saj dhe të identifikojë masa të tjera për trajtimin e tyre.







United Nations Conference on Housing
and Sustainable Urban Development



United Nations

www.habitat3.org
#NewUrbanAgenda #Habitat3